

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

PËRBUZJA E DYNJASË

Imam Gazali

Prishtinë, 2018

Ihjau Ulumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i originalit
Kitabu Zemmi'd-Dynja
Libri 26

Përgatiti dhe përktheu
Is'hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Lektor:
Shenaj Zeneli

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

PARATHËNIE

Falënderimi (hamd) i takon vetëm Allahut Teala, që robëte Tij të mirë i njoftoi me rreziqet dhe mangësitë e kësaj bote (dynjasë). Ata i panë ajetet dhe dëshmitë për këtë si dhe i krahasuan mirësitë e të këqijat e kësaj bote. E kuptuan që kjo botë ka më shumë të këqija se sa të mira, që ajo nuk ua plotëson dëshirat e nuk ua largon frikën dhe kuptuan që shkatërrimi i qenies së tyre është i detyrueshëm.

Në pamje, dynjaja është tërheqëse, si një femër e bukur, e që brenda fshehë ligësi. Ajo me pamje i tërheq njerëzit kah vetja, e ata që dëshirojnë të bashkohen me të i shkatërrojnë me të këqijat e saj. Atyre që e ndjekin u largohet, e ndaj atyre që i afrohen është koprrace. Nëse edhe u jep diçka, ata nuk janë të mbrojtur nga të këqijat e saj; nëse një orë u jep mirësi, një vit u jep ligësi. E kur një herë u jep ligësi, kjo u bëhet e zakonshme. Drejtimi i njeriut kah kjo botë dëshmon humbjen dhe shkatërrimin e tij. Fatkeqësitë e saj janë të vazhdueshme, dhe kërkuesit e saj ajo i poshtëron. Ai që mashtrohet me këtë botë detyrohet në poshttrim, e ai që mburret me të sigurisht që do të përfundojë i përmalluar.

Veçori kryesore e dynjasë është se ikë prej atij që e dëshiron, dhe e ndjekë atë që ikë prejsaj. Ata që i bëjnë hyzmet i braktisë, e ata që ia kthejnë shpinën, i kërkon. Qartësia e saj nuk është shpëtim nga turbullimi, e lumturia e saj nuk ndahet nga pikëllimi. Qetësia e saj është shqetësim, ndërsa rininë ia shkatërron pleqëria. Bollëku dhe bereqeti i saj sjellin vetëm mall e pendim. Është mashtruese, dinake dhe e keqe. Vazhdimisht stoliset për kërkuesit, e kur i lidhë ata për vete, i tregon dhëmbët e mprehtë dhe fillon të shfaqë veten, e duke ua përzier atyre rrugët, nuk lejon të shfrytëzohet nga ta me maturi. Atyre u shfaqë fshehtësi të habitshme por me shije vdekjeprurëse, dhe i godet me shigjeta që ndikojnë. Miqve të vet, deri sa ata janë në bollëk e lumturi, papritur ua kthen shpinën, e ata ndihen sikur vetëm kishin ëndërruar. Pastaj i merr ata nën tokë me qefin, dhe tërë trupin ua shkatërron. Miqtë e saj presin lumturinë, e ajo i mashtron dhe vazhdimisht i lë në shqetësim. Ata vrapojnë pas dëshirave të mëdha, mbledhin pasuri, ndërtojnë pallate. Ndërsa një ditë këto pallate u bëhen varr dhe pasuria u shkatërrohet; veprat u dalin të kota e dëshirat e paplotësuara. Pra, kjo është fshehtësia e brendshme e dynjasë. E në fund, çka është vullneti Allahut, ajo edhe bëhet.

Salat dhe selam Muhammedit, robit dhe të dërguarit të Allahut, i dërguar për botët si sihariqtar, paralajmërues dhe nur shkëlqyes. Salat dhe selam edhe ehli bejtit dhe as'habëve, që e ndihmuan në çështje të fesë.

Pas kësaj, dije se kjo botë (dynjaja) është armik i Allahut dhe i miqve të Tij, bile edhe armik i armiqve të Tij!

Dynjaja është armik i Allahut Teala sepse mundohet t'a ndërpresë rrugën e njerëve tek Ai. Për këtë arsye, Allahu Teala nuk e ka shikuar asnjë herë këtë botë (dynjanë), që nga krijimi i saj.

Dynjaja është armike e miqve të Allahut Teala për shkak që ajo stoliset për ta dhe i joshë me aroma e vizëllima, vetëm për t'i mashtruar. Ata detyrohen të shijojnë sherbetin e hidhur të përmbajtjes prej këyre stolive, për të shpëtuar nga ajo.

Ndërsa armiqtë kundër armiqve të Allahut Teala është për shkak se ata (armiqtë e Allahut) privohen nga lumturia e përrjetshme duke u dhënë pas shumëllojshmërisë së mashtrimeve, me të cilat dynjaja i tërheq në kurthin e vet, përfiton besimin e tyre, dhe bën që ata t'i mbështeten dynjasë. Ata kanë shijuar një frut të tillë të përmallimit, që ua ka shkatërruar mushkëritë. Ata do të digjen me mall për lumturinë dhe do të kërkojnë ndihmë për të shpëtuar nga mashtrimet e dynjasë, por nuk do të ndihmohen. Ndoshta vetëm do t'ju thuhet:

“Heshtni, mos folni.”

Për ta, Allahu Teala thotë:

“Këta janë ata të cilët jetën e kësaj bote e kanë blerë me jetën e ardhshme dhe atyre nuk do t'u lehtësohet dënimi as nuk do të ndihmohen.” 2-Bekare: 86

Fillimisht duhet të kuptohet natyra e vërtetë dhe përbërëja e dynjasë me gjithë këto gajle e të këqija të mëdha, hikmetin e krijimit të saj me kaq armiqtë dhe shkallën e përfshirjes së saj në mashtrim e keqbërje.

Kush nuk e njeh të keqen, nuk frikësohet nga ajo dhe lehtë bie në të. Pra, me ndihmën e Allahut Teala, e Allahu ndihmon në punët me të cilat Ai është i kënaqur, ne do të shpjegojmë përbuzjen e kësaj bote, hakikatin e kësaj, shembujt, hollësitë, domethënien dhe shkaktarët e angazhimit në punë të kota, e që nxisin në kryengritje kundër Allahut.

Kapitulli i parë

PËRBUZJA E DYNJASË

Të shumta janë ajetet dhe hadithet që përbuzin dynjanë. Pjesa më e madhe e Kur'anit flet për këtë, duke i ftuar njerëzit t'i drejtohen ahiretit dhe ta braktisin dynjanë. Kjo bile është edhe qëllimi dërgimit të pejgamberëve. E pasi kjo është shumë e qartë, nuk kemi nevojë të sjellim ndonjë dëshmi me ajete Kur'anore, prandaj do të përmendim vetëm disa transmetime:

Resulallahu s.a.v.s., po kalonte pranë një deleje të ngordhur, etha:

- Çfarë mendoni, a ka kjo dele e ngordhur ndonjë vlerë në sytë e pronarit të saj? Ata thanë:

- Ai edhe e hodhi këtu sepse nuk ka vlerë,e

Resulallahu s.a.v.s., tha:

- Beto hem në Allahun, në dorën e të cilit është shpirti im, kjo botë tek Allahu është më e pavlerë se sa kjo dele tek pronari i vet. Po të vliente dynjaja tek Allahu aq sa krahu i një mushkojne, Allahu Teala nuk do t'i jepte qafirit as një gllënjë ujë për të pirë nga kjo dynja.¹

Resulallahu s.a.v.s. gjithashtu thotë:

“Dynjaja është burg i besimtarit, e xhenet i qafirit.”²,dhe:

“Dynjaja është e mallkuar, gjithçka në të është e mallkuar, përveç asaj që është për Allahun.”³

¹ Ibn Maxhe dhe Hakim Sehl b. Sad.

² Muslim nga Ebu Hurejre r.a.

³Tirmidhi, dhe Ibn Maxhe, nga Ebu Hurejre r.a.

Ebu Musa Esh'ari r.a., transmeton se Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Kush e do dynjanë, e dëmton ahiretin e vet; e kush e do ahiretin, e dëmton dynjallëkun. Prandaj zgjedhni të përhershmen.”⁴

Me një hadith tjetër, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Dashuria për dynjanë është koka e të gjitha gabimeve.”⁵

Zejd b. Erkam tregon: *“Ishim bashkë me Ebu Bekrin r.a., e ai kërkoi ujë. I sollën mjaltë e ujë, e kur e pa këtë, Ebu Bekri filloi të qajë. Aq qante sa i bëri edhe as'habët të qajnë. Ata u ndalën, por ai vazhoi e qante. Menduan se as nuk do të mund t'a pyesin pse qanë. E më në fund, duke i fshirë lotët, Ebu Bekri filloi të tregojë:*

- Isha me Resulallahun s.a.v.s., dhe e vërejta t'i thotë dikujt, me fjalë e lëvizje: ‘Largohu prej meje!’, e aty nuk dukej askush. E pyeta: ‘O i Dërguar i Allahut, kush është që po e dëbon?’; e më tha:

- Kjo dynja m'u afrua dhe dëshiroi që ta dua, e unë i thashë të largohet prej meje. Pasi u largua, u kthye e më tha: ‘Edhe nëse ti ke shpëtuar prej meje, ata që vinë pas teje nuk do të shpëtojnë.’⁶

Resulallahu s.a.v.s. gjithashtu thotë:

“Çudi qysh ai që beson se ahireti është i përjetshëm, e harxhon kohën për dynjallëk mashtrues.”⁷

⁴ Transmetojnë Ahmed, Bezzar, Teberani dhe Ibn Hiban. Hakimi thotë që është sahih.

⁵ Ibn Ebi'd Dynja dhe Bejhaki nga Hasani.

⁶ Transmeton Bezzariu. Hakimi thotë që është sahih.

⁷ Transmeton Ibn Ebi' ed-Dyn'ja me sened mursel nga Xheriri.

Sipas një transmetimi, Resulallahu s.a.v.s., duke kaluar pranë një vendi mbeturinash, tregoi kah një bezi kalbure një kockë e shkatërruar, dhe tha:

“Ja - kjo është dynjaja; kështu e ka përfundimin.”⁸

E me një hadith tjetër:

“Dynjaja është një bahçe e ëmbël dhe e gjelbër. E juve Allahu Teala ju ka bërë halife në dyjna, që të shohë si veproni. Kur bijtë e Israelit arritën në mirëqenie, ata u dalldisën në roba e aroma, me gra e stoli.”⁹

Isa alejhisselam ka thënë:

“Mos e merrni dynjanë si zotërinë tuaj, do t’ju robërojë. Pasurinë mbliidheni aty ku nuk humbet; poseduesi i pasurisë së dynjasë ka frikë se thesari i shkatërrohet, por për ata që janë posedues të pasurisë së Allahut, një frikë e tillë nuk ekziston.”

E gjithashtu ka thënë:

“O Havarijjët e mi, unë e rrëzova dynjanë për ju. Mos lejoni që ajo të qohet në këmbë pas meje.

Dëshmi e të keqes së dynjasë është fakti se në të ka kryengritje kundër Allahut, e dëshmi është edhe fakti se ahireti fitohet vetëm me braktisjen e dyjnasë. Dynjanë pranojeni vetëm si vendkalim, mos e kultivoni sikur ahiretin, dhe dijeni se koka e të gjitha gabimeve është dashuria për dynjanë. Mos harroni që për një kënaqësi të shkurtë nevojitet një pendimi gjatë.”

⁸ Ibn Ebi’ed-Dyn’ja dhe Bejhakui me sened mursel nga Mejmun.

⁹ Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Ebu Sad, por ka edhe rrugë tjera të transmetimit.

Dhe ka thënë:

“Dynjaja është bërë shtrat për ju, e ju uluni mbi të, por mos lejoni që për dynja t’ju urrejnë sulltanët e gratë; sulltanët nuk ju bezdisin nëse dynjallëkun ua dorëzoni atyre, e nga gratë ruajuni me agjërim e namaz.”

Isa a.s. gjithashtu kë thënë:

Dynjaja kërkon, dhe kërkohet. Ajo kërkon njeriun e dhënë pas ahiretit, që t’ia plotësojë riskun. E ata që kërkojnë dynjanë, ata i kërkon Azraili, që t’ua marrë shpirtin.”

Musa b. Jesar r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

Allahu Teala nuk ka krijuar asgjë më të pavlerë se dynjaja, dhe prej se e ka krijuar, nuk e ka shikuar.¹⁰

Sulejmani alejhisselam po udhëtonte, zogjtë i bënin hije mbi kokë, nga e djathta dhe e majta e shoqëronin njerëz e xhinë. Arritën te një abid nga bijtë e Israelit, e abidi tha:

- O biri i Davudit! Allahu Teala të ka dhënë ty pasuri të madhe! Sulejmani a.s., e dëgjoi, e i tha:

- Një tesbihi shkruar në fletore të besimtarit është më me vlerë se gjithë pasuria e dhënë Sulejmanit, birit të Davudit. Pasuria e Sulejmanit humbet, vlera e tesbihut, nuk humbet.

¹⁰ Ibn Ebi’d – Dyn’ja dhe Bejhaki, si hadith mursel.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

Kamja ju bëri gafil. Njeriu thotë: ‘e imja, e imja’, ndërsa e tij është vetëm ushqimi që e ha e pastaj e qet, rrobat që i veshë e pastaj i gris edhe atë që e jep për rizanë e Allahut - e kjo i mbetet përgjithmonë.¹¹

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

Dynjaja është shtëpi për atë që nuk ka shtëpi, e pasuri për atë që nuk ka pasuri; dynjallëkun e mbledhë ai që nuk ka mend, për të sulmon ai që nuk ka dituri, për të ka zili ai që nuk kupton, për të mundohet ai që nuk ka bindje në besim.¹²

Dhe përsëri, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

Kush zgjohet në mëngjes me dëshirë të madhe për dynjallëk, Allahu i vendosë në zemër katër gjëra: (1) telash të vazhdueshëm; (2) angazhim që nuk ndalon; (3) varfëri që nuk kalon; si edhe(4) dëshirë që nuk arrihet.¹³

Ebu Hurejre tregon:

“Resulallahu s.a.v.s., më tha:

-O Ebu Hurejre, a të tregoj dynjanë me gjithë çka ka? I thashë: “Po, o i Dërguar i Allahut” e Resulallahu s.a.v.s. më kapi dorën e më dërgoi në një përrua me mbeturina; kafka njerëzish, bërllug, veshje të copëtuara e eshtra dhe më tha:

- O Ebu Hurejre! Këto koka lakmonin dynjanë, njëjtë sikur ju; shpresonin siç shpresoni edhe ju, e sot – ato janë

¹¹ Muslimi nga Abdullah b. Shihiri.

¹² Ahmed i nga Ajsha r. anha

¹³ Taberani në veprën ‘Evsat’ nga Ebu Dher, e ka edhe transmetime tjera.

vetëm kocka pa lëkurë, e shpejt do të bëhen pluhur. Ky bërlllog janë ushqimet e ndryshme që ata kanë ngrënë e të cilin e kanë fituar ashtu si e kanë fituar, dhe e kanë shijuar në stomakët e tyre, e sot –sot njerëzit ikin prej kësaj. Këto eshtra janë eshtrat e kafshëve të tyre me të cilat kanë shëtitur. Prandaj, kush dëshiron të qajë për dynjanë – le të qajë!

Shkurt pas kësaj, filluam të qajmë, me zë.”

Tregohet se, kur Allahu Teala e zbriti Ademin a.s., në tokë, i tha:

“Ndërto, që të shkatërrohet! Shumohu, që të zhduken!”

Davud b. Hilal ka treguar se në fletushkat e Ibrahimit a.s., shkruan: *“O dynja, stolitë e tua të rreme në syrin e të mirëve nuk kanë vlerë. Në zemrat e tyre Unë vendosa urrejtje dhe refuzim ndaj teje, dhe i frymëzova që të ta kthejnë shpinën. Nuk kam krijuar asgjë më pa vlerë se ty. Çdo gjendje e jotja do të shkatërrohet. Që nga dita e parë e krijimit të kam përcaktuar që ti nuk do të vazhdosh për askë dhe që askush nuk do të qëndrojë vazhdimisht te ti. Myzhde atyre që besojnë në Mua dhe që, duke zbatuar urdhrat e fesë, ndjekin rrugën e drejtë. Prapë myzhde atyre kur të ngrihen nga varret e tyre e të vijnë tek Unë me nur që shkëlqen para tyre e të rrethuar me melekë; ata do të arrijnë mëshirën që kanë shpresuar!”*

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

Dynjaja është hapësira mes tokës e qiellit. Allahu Teala nuk e ka shikuar atë që nga dita kur e ka krijuar, e në ditën e kiametit dynjaja do të thotë: “O Rabbi im, më bëj mua vendbanim, bile për velitë e t’u me vlerë më të ulët”, e Allahu Teala do t’i thotë:

- O ti që je një hiç! Unë nuk pranova të t’i japë ata as në atë jetë, e si mund të t’i japë në këtë jetë?!¹⁴

Tregohet se, kur Ademi a.s., hëngri frutin nga pema e ndaluar, e shtrënguan zorrët për të hedhur mbetjet. Deri atëherë, nga të ngrënit nuk kishte mbetje. Për këtë arsye kjo pemë edhe ishte ndaluar. Kur u detyrua, Ademi a.s., filloi të kërkojë një vend në xhenet. Allahu Teala iu drejtua, përmes një meleku:

- *Tregoi Rabbit tënd çfarë po kërkon?*, e Ademi a.s., u përgjigj:

- *Dua të lehtësohem nga mundimi në bark.*

Atëherë meleku i tha Ademit a.s.:

- *E ku mendon t’a lësh? Cilin minder të xhenetit, cilin lum të tij, apo hijen e cilës pemë në xhenet kërkon ta bësh pis? Diçka e tillë këtu nuk bëhet, lëshohu në dynja!*

Sa e pavlerë është kjo dynja!

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

- Në ditën e kijametit do të sillen ata që kanë vepra sa mali Tihame e do të jepet urdhri që të dërgohen në xhehenem.

- *O i dërguari i Allahut, a kanë falë këta namaz?, e pyetën as’habët, e Resulallahu s.a.v.s., ju tha:*

¹⁴ Transmeton Musa b. Jesar, e një pjesë është cekur më lartë.

- Po. Ata falen, agjërojnë, bile edhe ndajnë një pjesë të natës për ibadet. Por kur kanë ndonjë mundësi nga dynjallëku, pa menduar a është haram apo hallall, hidhen mbi të.¹⁵

Me një hutbe, Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

- Besimtari është mes dy frikave; mes frikës se si do ta trajtojë Allahu Teala të kaluarën e tij, dhe frikës se çka i ka caktuar Allahu për pjesën e mbetur të jetës së tij. Atëherë, përfito për vete - prej vetes, për ahiretin prej dynjasë, për vdekjen prej jetës, për pleqërinë prej rinisë. Sepse dynjaja është krijuar për ju, e ju jeni krijuar për ahiret. Pasha Allahun, në dorën e të cilit është shpirti im, pas vdekjes nuk mund të bëhet asnjë vepër që bëhet sepse për falje dhe pas dynjasë nuk ka vend tjetër përveç xhenetit dhe xhehenemit.¹⁶

Musa a.s., ka thënë:

“Siç nuk është e mundur të bashkohen uji e zjarri në një tas, as dashuria për dynjanë dhe ajo për ahiretin nuk mund të bashkohen nënjë zemër.”

Tregohet se Xhebraili a.s., e pyeti Nuhin a.s.:

- *O pejgamberi me jetën më të gjatë, si e sheh ti dynjanë?,* e Nuhi a.s., u përgjigj:

- *Është si një shtëpi me dy dyer, hyra në njërën e dola prej tjetrës.*

¹⁵ Ebu Nuajm.

¹⁶ Bejhakiu në *‘Shu’abu’l-Iman’* nga Hasani.

I thanë Isasë a.s.:

*-Të kishe bërë së paku një shtëpi, sa përt'u strehuar, e
Isa a.s., tha:*

- Neve na mjaftojnë rrënojat e vjetra për banim.

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Ruajuni nga dynjaja; ajo ju bën magji më shumë se
Harutie Maruti.”¹⁷**

Resulallahu s.a.v.s., ju tha as’habëve të tij:

**A ka dikush prej juve që dëshiron t’i largohet verbëria
shpirtërore e t’i çelet zgjuarsia? Duhet ta dini se, aq
dikush e dëshiron dynjanë, aq sa vrapon pas saj, po aq
Allahu Teala ia verbëron zgjuarsinë. Ai që nuk e do
dynjanë dhe nuk vrapon pas saj, Allahu Teala i dhuron
zgjuarësi dhe e udhëzon në rrugë të drejtë. Kuptoni mirë!
Pas juve do të vinë njerëz të tillë që dynjallëkun do ta
qeverisin vetëm me dhunë e gjak, pasurinë do t’a fitojnë
me kopraci e mendjemadhësi, e dashurinë do të kërkojnë
duke iu lëshuar epsheve. Ai prej jush që i arrin ato ditë, e
mund të fitojë me kopraci e mendjemadhësi por e duron
varfërinë, mund të gjejë dashuri duke iu lëshuar epsheve
por nuk e bën, i reziston armiqësisë, mund të përfitojë
respekt jashtëligjishëm por duron nënçmimin, e bën
kështu duke menduar vetëm për rizanë e Allahut Teala,
Allahu atij do t’i japë shpërblimin e pesëdhjetë
sidikëve.”¹⁸**

¹⁷ Bejhakiu nga Ebu Derda.

¹⁸ Bejhakiu nga Ebu Derda.

Tregohet se Isanë a.s., në rrugë e zuri shi i rëndë me bubullimë të tmerrshme. Filloi të kërkojë një strehë. E pa një çadër përpara dhe vrapoi atje. Në çadër ishte një grua dhe ai u largua nga aty. E pa një shpellë, e kur hyri aty, e pa një luan. Doli nga shpella, e tha:

- *O Rabb, Ti secilit i ke dhënë një strehë, por mua nuk më dhe asnjë.* Allahu Teala i tha:

“Streha jote është rahmeti Im. Në ditën e kiametit do të të martoj ty me njëqind Hyri e dasma do të vazhdojë katër mijë vjet, secila ditë e barabartë me njëmijë vite në dynja. Tellallit do t’i urdhëroj të thërrasë: ‘Ku janë ata që ia kanë kthyer shpinën dynjasë? Sot ejani e merrni pjesë në dasmën e Isasë a.s., birit të Merjemit, i cili ia ka kthyer shpinën dynjasë!’.

Isa a.s., gjithashtu ka thënë:

“Haram u qoftë atyre që vrapojnë pas dynjallëkut e domosdo do t’u braktisin atë. Por, ata janë lidhur për dynjallëk dhe janë të mashtruar prej saj, dhe ata që u lidhën për të, dynjaja i bëri rezil. Dhe prapë, haram u qoftë atyre që me dynjallëk kënaqen, e kjo dyjna do t’ju tregojë atyre se ajo nuk kënaqet me ta. Ajo do t’i ndajë nga të dashurit dhe do t’i dërgojë në destinimin e fundit. Haram u qoftë atyre që mendimin e kanë vetëm për dynjallëk e punën e kanë kryengritje, nesër do të turpërohen me gjynahe.”

Tregohet se Allahu Teala, i ka shpallur Musasë a.s.:

“O Musa! Çfarë lidhje ke ti me dynjallëkun - shtëpinë e mizorëve? Nuk është vendi yt aty. Mos mendo për atë vend, ai është një vend i shëmtuar.

Përpos për ata që bëjnë punë të mira, për ta është vend i mirë. O Musa, sigurisht që Unë e vështroj mizorin dhe marr hakun e të shtypurit prej tij.”

Resulallahu s.a.v.s., e dërgoi Ebu Ubejd b. Xherrahun r.a., në Bahrejn. Ky solli shumë mallra nga atje, e kur dëgjuan Ensarët, e mbushën xhaminë në namazin e sabahut. Pas namazit filuan të flasin për Ebu Ubejdin, e Resulallahu s.a.v.s., buzëqeshi dhe ju tha:

- Me se duket keni dëgjuar se Ebu Ubejde erdhi me shumë mallra.

Ata pohuan, e Resulallahu s.a.v.s, ju tha:

- Gëzohuni e kënaquni me gjërat që ju pëlqejnë. Vallahi, unë nuk frikësohem për juve prej varfërisë, por po frikësohem se edhe ju do ta doni dynjallëkun sikur ata para jush, e të xhelozoni njëri-tjetrin për dynjanë sikur ata para jush, e të ju shkatërrojë dynjaja, sikur ata para jush.¹⁹

Ebu Said Hudri transmeton se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

- Më së shumti që frikësohem për ju është për bereqetet që Allahu Teala do të nxjerrë nga toka për ju.

E pyetën: *“Çka janë këto bereqete?”* e Resulallahu s.a.v.s. tha:

- Zbukurimet e dynjasë.²⁰

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Mos lejoni që përkujtimi i dynjasë t’ju zaptojë zemrat.”²¹

¹⁹ Buhriu dhe Muslimi nga Amr b. Avf el-Bedri.

²⁰ Buhriu dhe Muslimi.

Sipas tregimit të Ammar b. Sad, Isa a.s., me Havarijjet arriti në një fshat. Njerëzit e atij fshati ishin shtrirë të vdekur para dyerve të shtëpive e në rrugë. Isa a.s.,tha:

- *Sigurisht që këta fshatarë kanë vdekur për shkak të zemërimit të Allahut. Po të kishin vdekur zakonshëm, sigurisht që ata do të varrosnin njëri-tjetrin.*

Havarijjet thanë:

- *Duam të dimë çka ishin gjynahet e tyre!* Isa a.s., e kërkoi këtë prej Allahut Teala, e Allahu ishpalli:

- **Thirri ata natën, e ata do të përgjigjen.**

Kur u bë natë, Isa a.s., doli mbi një kodër të vogël dhe thirri:

- *O fshatarë! Çka është kjo gjendje e juaj, a na tregoni si u bë kjo?* Njëri prej tyre tha:

- *O Ruhi i Allahut, ne shkuam në gjumë shëndosh e mirë, e në mëngjes e gjetëm veten në xhehenem!* Isa a.s., e pyeti:

- *Pse u bë kështu?*, e ky i tha:

- *Për shkak që u dalldisëm në dashuri për dynjallëkun dhe ju dorëzuam gjynaheve.* Isa a.s., pyeti:

- *Si e dashuruat dynjallëkun?*, e ky i tha:

- *Si fëmiu që e do nënën, që kur vjen ajo ky gëzohet, e kur largohet, qanë; edhe ne – gëzoheshim kur vinte dynjallëku e qanim kur largohej.*

Isa a.s., e pyeti:

- *Pse nuk përgjigjen të tjerët?*, e ai i tha:

- *Si të përgjigjen, në gojë u janë vendosur dizgjin zjarri, e janë në duar e zebanive!* Isa a.s., tha:

- *E ti, si po mund të përgjigjesh?*, e ai tha:

²¹ Bejhakiu dhe Ibn Ebi'd-Dynja nga Ebu'n-Nadr el-Harisi.

- Unë nuk jam nga ata, edhe pse isha mes tyre. Por, kur edhi dënimi (azab), më morri edhe mua, e tash jam i varur në buzë të xhehenemit dhe nuk di a do të shpëtoj.

Atëherë, Isa a.s., u tha Havarijjeve:

- *Vallahi, edhe buka me kripë, rrobat e shajakut e fjetja në tokë janë teprim për atë që mundohet të jetë i drejtë, edhe me dynja edhe me ahiret.*

Enesi r.a., tregon: “*Deveja e Resulallahut s.a.v.s., me emër Abda ishte një deve e pakalueshme në vrapim. Kur deveja e një beduini e kaloi devenë e Resulallahut s.a.v.s., as’habëve u erdh rëndë, e Resulallahu s.a.v.s., tha:*

- ***Çdo gjë që Allahu Teala e lartëson nga dynjallëku, gjithsesi se do ta ulë, ky është urdhër i prerë i Allahut Teala.***²²

Isa a.s., ka thënë:

“*Kjo dynja është e qëndrueshme aq sa mund të ndërtohet shtëpi në dallgëtë detit.*”

Kur i thanë Isasë a.s.: “*Na mëso diçka që të përfitojmë dashurinë e Allahut Teala*”, Isa a.s., ju tha:

- *Përbuzni dynjanë që t’ju dojë Allahu.*

Ebu Derda r.a., tregon nga Resulallahu s.a.v.s.:

- ***Sikur të dinit atë që di unë, pak do të qeshnit, e shumë do të qanit, Sigurisht që dynjaja nuk do të kishte vlerë për ju dhe sigurisht që do të kishit preferuar ahiretin.***²³

²² Buhariu nga Enesi

²³ Buhariu dhe Muslimi nga Enesi r.a, e ka edhe rrugë tjera të transmetimit.

E duke vazhduar, Ebu Derda r.a., thotë:

“Sikur të dinit edhe atë që di unë, do të dilnit në male e të qanit veten, do të braktisnit pasurinë tuaj e nuk do t’i ktheheshit, përpos asaj çka është e domosdoshme. Por, nga zemrat tuaja është zhdukur kujtimi për ahiretin e aty është vendosur shpresa, prandaj dynjallëku mbizotëron veprimet e juaja. Jeni bërë sikur ata që nuk kuptojnë; disa nga ju edhe më të këqij se kafsha, duke mos lëshuar kërkesat, nga frika! Çfarë keni kështu, që nuk duheni e nuk këshilloheni mes vete, e jeni vëllezër në fe. Epshtet tuaja dallojnë vetëm sipas prishjes së brendisë tuaj, e sikur të mbildheshit në të mirë, do të duheshit mes vete. Çfarë keni, e nuk këshilloheni mes vete për çështje të dynjasë, e as për ahiret; asnjëri prej jush nuk dëshiron që t’i japë bile një këshillë të mirë atij që e do dhe e përkrahë për ahiret!

Krejt kjo është pasojë e mungesës së besimit në zemrat tuaja. Po të ishit të bindur në të mirën e ahiretit dhe në të keqen e tij, ashtu siç besoni në këtë dynja, do t’i jepnit përparësi kërkimit të ahiretit, sepse kjo është më e mirë për juve.

Ju thoni se dashuria për jetën e kësaj bote mbizotëron, e ne ju shohim si i jepni përparësi asaj që është e përkohshme, në dëm të asaj që do t’ju sillte dobi në ahiret. Ju ngulfateni me lodhje e veprime duke kërkuar atë që, ndoshta, as nuk do ta arrini. Sa popull i keq që jeni! Besimin (imanin) ju nuk e keni kuptuar ashtu siç u është shpjeguar. Nëse keni dyshim në ato që ka sjellë Muhammedi (s.a.v.s.), atëherë ejani te ne t’ju shpjegojmë dhe t’ju tregojmë dëshmitë që qetësojnë zemrat. Pasha Allahun, nuk jeni ju axhami, e t’ju falet; ju shumë mirë e njihni mendimin e drejtë kur është në pyetje dynjallëku i juaj. Çfarë keni, e

gëzoheni kur fitoni pak nga kjo dynja, dhe vuani kur diçka ju ikë, dhe kjo mund të shihet në fytyrat tuaja, e edhe në gjuhët tuaja – ju këto i quani vështirësi dhe në aso raste vuani bashkarisht. Shumica prej jush e ka braktisur pjesën më të madhe të fesë, e as që ju ndërron qehrja. Vallahi, po shihet që Allahu Teala nuk është me juve! Mes vete takoheni me gëzim, e asnjëri nuk ka qejf ta takojë shokun me ndonjë të metë, duke u frikësuar se edhe vet bëhet ashtu. Shoqëroheni mes vete, e nuk e duroni njëri-tjetrin! Kullotat e juaja rriten mbi mbeturina, fitimet e juaja janë haram, kontrata e juaj është ndërtuar mbi prishje të kontratës, te ju nuk ka mbetë asgjë nga sinqeriteti. Vërtetë dua që Allahu të më largojë prej juve, e të më afrojë Pejgamberit. Po të ishte Pejgamberi gjallë, nuk do të heshtja për këto veprime të juaja!

Nëse në juve ka ndonjë të mirë, ua kam përmendur, e nëse kërkoni për atë që është te Allahu, kjo lehtë gjendet. Nga Allahu kërkoi strehim nga sherri juaj dhe ndihmë kundër jush.”

Isa a.s., u tha Havarijjëve: “O Havarijjët e mi! Kënaquni me pak dynjallëk, që besimi t’ju mbetet i drejtë, mu ashtu siç janë të dashuruarit në këtë botë të kënaqur me pak besim e shumë dynjallëk.”

*Në këtë kuptim janë edhe vargjet:
I shoh njerëzit, kënaqen me pak besim,
por nuk kënaqen me pak prej dynjasë.
Për besim, braktise botën e sunduesve,
si e braktisën ata besimin, të dhënë pas dynjasë.*

E Isa a.s., gjithashtu ka thënë: *“O ti që kërkon dynjallëkun, puno mirë; e puna më e mirë është braktisja e dynjallëkut.”*

Ndërsa Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Vërtetë pas meje do t’ju çelet dynjaja e do të shkatërrojë besimin tuaj si zjarri që shkatërron drutë.”

Allahu Teala i shpalli Musasë a.s.:

“O Musa! Mos iu dorëzo zbukurimeve të kësaj bote, sepse ky është gjynahu më i madh me të cilin mund të vish para Meje.”

Musa a.s., kaloi pranë një njeriu që po qante, e edhe kur u kthye e gjeti duke qarë, e tha: *“O Rabb! Robi yt po qanë nga frikë-respekti për ty.”*Allahu Teala i tha:

“O i biri i Imranit! Sikur edhe truri t’i rridhte bashkë me lotët, nuk do ta fali, për shkak që në zemër të tij ka dashuri për dynjallëkun.”

FJALËT E AS’HABËVE DHE DIJETARËVE NË KËTË TEMË

Hazreti Alia r.a., ka thënë:

“Ai që i ka këto gjashtë veçori, është në rrugë të xhenetit dhe largohet nga xhehenemi: (1) e njuh Allahun Teala dhe i nënshtrohet; (2) e njuh shejtanin dhe e kundërshton; (3) e njuh Hakkun dhe e pason; (4) e njuh rrugën e gabuar dhe i ruhet; (5) e njuh dynjanë dhe e braktisë; dhe (6) e njuh ahiretin dhe e kërkon.”

Hasan Basriu ka thënë:

“Allahu pastë rahmet ndaj atyre nën kujdesin e të cilëve ishte kjo dynja, e ata ia kthyen Atij që ua ka dhënë, dhe e lëshojnë dynjanë duarthatë.”

E Hasani gjithashtu ka thënë:

“Kush bën gara me ty në fe, pranoje garën, e kush bën gara në dynjallëk, hedhja dynjallëkun në gjoks.”

Llukmani a.s., i tha të birit: *“Evlad, dynjaja është det i thellë e të shumtë janë ata që në të fundosen. Prandaj në atë det, anije bëje takvallëkun tënd, brendësi të anijes bëje besimin në Allah, e vela të saj letë bëhen mbështetja jote në Allahun Teala; ndoshta kështu shpëton, përndryshe shpëtimi është shumë i vështirë.”*

Fudajli ka thënë: *“Gjatë mendova për këtë ajet Kur’anor:*

“Çdo gjë që gjendet në Tokë, Ne e kemi bërë stoli për të, për të provuar se kush prej tyre punon më mirë.

Dhe, Ne do ta bëjmë të shkretë gjithçka që gjendet në të.”(18-Kehf: 7, 8).”

Një i urtë ka thënë: *“Çkado që të arrish nga kjo dynja, ta dish se dikush para teje tashmë e ka arritur atë, dhe do ta arrijnë edhe pas teje. Nga dynjaja, e jotja është vetëm ushqimi për një natë e një ditë, prandaj mos e tepro me ushqim dhe përmbahu nga dynjallëku, e krejt çka merr prej saj le të jenë për ahiret. Dëshirat e përkohshme janë kapital i dynjasë, e fitimi i saj është zjarri.”*

E pyetën një zahid çka mendon për kohën, e tha:

- *Vjetron trupat, ripërsëritë veprimet, afron vdekjen, largon dëshirat. E pyetën:*

- *Si është puna e atyre që janë dhënë pas dynjasë?, e ai u përgjigj:*

- *Kush arrinë t'a fitojë - lodhet, e atë që dynjaja e anashkalon, është me fat.*

Për këtë, është thënë:

*Kush lavdëron dynjanë për qejfet që ia ofron,
s' do të kalojë shumë kohë, e ky do t'a shajë.
Kur dynjaja i kthen shpinën, pikëllimi e mbulon,
e kur krejt i shkon për qejfi, brenga e kaplon.*

Një i urtë ka thënë: "Dynjaja është krijuar, e unë nuk kam qenë, prapë unë nuk do të jem, e dynjaja do të vazhdojë. Prandaj nuk i besoj dynjasë, sepse jeta në të është e vështirë dhe e shkurtë, pastërtia e saj është e turbullt, ata që jepen pas saj i kaplon frika se mos po humbet bukuria e saj, ose frika nga sprovat e dynjasë që mund t'i kaplojnë, ose frika nga vdekja që do t'i përfundojë."

Dikush pat thënë: "Turp i dynjasë është se ajo nuk i jep askujt aq sa meriton ose i nevojitet, por gjithmonë jep më shumë, ose më pak."

Sufjani ka thënë: "A nuk e sheh, të mirat sikur janë të mallkuara; shkojnë te ata të cilëve nuk ju takojnë."

Ebu Sulejman Darani ka thënë: *“Kush e do dynjanë, sa herë të merr diçka prej të mirave të saj, do të kërkojë më shumë. Edhe kush e do ahiretin, sa herë të merr diçka prej të mirave të tij, do të kërkojë më shumë, e dëshira nuk ka fund.”*

Një person iu ankua Ebu Hazimit: *“Po ndjej se më tërhjekë dynjaja, por nuk mendoj se ajo është vendbanimi dhe shtëpia ime”*, e ky ia ktheu:

- *Shiko çfarë të ka dhënë Allahu Teala nga dynjallëku dhe merr vetëm atë që është e lejuar dhe përdore vetëm për çka është dedikuar, e kështu tërheqja kah dynjallëku nuk do të të dëmtojë.* Ebu Hazimi e këshilloi kështu sepse po t'i thoshte të kundërtën e ta qortonte, do ta fuste personin në një situatë të vështirë.

Jahja ibn Muadh ka thënë: *“Dynjaja është dyqan i shejtanit. Mos vjedh asgjë nga dyqani i tij, sepse shejtani e kërkon mallin që e ke vjedhur, dhe të zë.”*

Fudajli ka thënë: *“Edhe po të ishte dynjaja prej ari – do të shkatërrohet, ndërsa ahireti, edhe do të ishte nga balta, është i përhershëm, prandaj duhet zgjedhur përhershëm, por si ta bëjmë këtë, kur ne kemi zgjedhuratë përkohshmen ndërsa kemi anashkaluarta përhershmen.”*

Ebu Hadhim ka thënë: *“Ruajuni nga dynjaja! Kam dëgjuar se ai që madhëron dynjanë do të ndalet në Ditën e Gjykimit, dhe do të thuhet:*

- *Ky është ai që madhëronte atë që Allahu Teala e ka përbuzur.”*

Ibn Mesud r.a.ka thënë: *“Secili person në dynja është mysafir, e prona që e ka i është amanet; mysafiri udhëton, e amaneti kthehet.”*

Në këtë kuptim, është thënë:

*Prona e familja, të janë amanet,
E amaneti kthehet, këtë e di dhe vet.*

Një ditë, miqtë e vizituan Rabija Adevijjen, dhe nisën të flasin gjitha të këqijat për dynjanë. Ajo u tha:

- Heshtni e mos e përmendni dynjanë! Po të mos kishte dynjana vend në zemrat tuaja, nuk do të flisnit aq shumë për të. Dihet se ai që do diçka, atë e përmend shumë.

E pyetën Ibrahim Ed'hemin se si ndihet, e u përgjigj:

*Arnojmë dynjallëkun, fenë duke e grisur,
kështu që të dyja, kem' për t'i bitisur.
Lum rob i që zgjedh Allahun, Rabbin e vet!
Dynjanë e bën kurban, për ahiret.*

E për këtë, gjithashtu është thënë:

*I dashuruari pas dynjasë,
sa do asaj i gëzohet e sa do që të jetojë,
e sa do që nga dynjaja i tilli të përfitojë,
në fund është si mjeshtri që ndërton shtëpi,
e sapo të ndërtohet, shtëpia i bëhet hi.*

E është thënë edhe kjo:

*Shih se si dynjallëku të josh,
a thua gjithë kjo ndojherë përfundon?
Dynjallëku yt është sikurnjë hije,
pak të jep freski, e pastaj zhduket, shkon.*

Llukmani i tha djalit të tij:

“Evlad! Shite dynjanë për ahiret, dhe kështu do t’i fitosh të dyjat. E mos e shit ahiretin për dynja, se do t’i humbasësh të dyjat.”

Mytarrif ibn Shihhir ka thënë:

“Mos shiko rehatinë dhe lluksin në të cilin jetojnë sunduesit, por shiko si largohen ata shpejtë dhe sa i keq është përfundimi i tyre.”

Ibn Abbas r.a., ka thënë:

“Allahu Teala e ka ndarë dynjanë në tri hise: një hise për besimtarët, një për hipokritët dhe një për jobesimtarët. Besimtari e përdorë hisen e vet për ahiret, hipokriti që të zbukurohet me të, e jobesimtari me të kënaqet.”

Dikush ka thënë: *“Dynjallëku është cofëtinë. Kush dëshiron diçka nga ajo, le të jetë gati të jetojë me qentë.”*

E në këtë kuptim janë edhe vargjet në vazhdim:

*O ti, që dynjanë lypë t’a martosh!
heq dorë prej saj, e do të shpëtosh.
Kjo që ti lypë ta martosh, fenë t’a shkatërro,
E ajo dasmë, besa edhe varrimi yt - po afro.*

Ebu Derda ka thënë: *“Dëshmi që dynjaja është e pavlerë te Allahu Teala është fakti se vetëm në dynja bëhen gjynahe, dhe se fitimi i rizasë së Allahut është i mundur vetëm nëse braktiset dynjaja .”*

Këtë e thonë edhe vargjet:

*Nëse i mençuri e provon dynjanë,
kjo i del armik, i veshur si mik.*

E gjithashtu është thënë:

*O ti gjumash, po gëzohesh kur vjen nata,
e belaja edhe n'sabah mundet me të nxanë.
Kohët kur njerëzit bënëin qejfe t'gjata
u fshinë nga kohë të reja, e as ato më s'janë.
Sa e sa sundues koha i rrëmbeu,
të mirë e të këqij, ajo s'i kurseu.
O ti që e përqafton dynjanë,
në të s'do të jesh gjithmonë!
Do të perëndosh, e të agosh, e të udhëtosh...
Pra, nga kjo dynja boshe ik, largohu,
E hyrive t'bukra në xhenet Firdeus, afrohu.
Nëse e sheh veten në bahçe t'xhenetit shtruar,
Atëherë mos mendo se zjarrit i ke shpëtuar!*

Ebu Umame Bahili r.a., tregon:

*"Kur Muhammedi s.a.v.s., u dërgua si peygamber,
erdhën te iblisi ushtarët e tij shejtanë dhe thanë:*

*- U dërgua një peygamber dhe rreth tij u mbledh
ummeti i tij.*

Iblisi i pyeti:

- A e do ummeti i tij këtë dynja?, e i thanë që po.

Atëherë, Iblisi tha:

*- Nëse e donë këtë dynja, atëherë nuk brengosem pse
nuk adhurojnë statuja. Unë do t'i sulmoj me tri gjëra, në
mëngjes dhe në mbrëmje: përmes pasurisë që e fitojnë
haram, përmes pasurisë që e harxhojnë haram dhe përmes*

pasurisë që e grumbullojnë haram; e prej kësaj dalin të gjitha të këqijat.“

Një person i tha Alisë r.a.:

-O prijës i besimtarëve! Më trego çka është dynjaja?, e Alia r.a., iu përgjigj:

- Çka mund të them për shtëpinë ku njeriu është shëndosh e sëmuret, ndihet i sigurtë e pastaj i bie pishman, varfërohet e për këtë pikëllohet, pasurohet e kështu sporovohet; çfarë të them për shtëpinë për hallalln e të cilës do të jepet llogari e për haramin e së cilës do të merret dënim, e për gjërat e dyshimta, do të meritohet qortimi.

la kërkuan këtë prapë, e hazreti Alia r.a., u tha:

- T'ju tregoj shkurt apo gjatë?

- Shkurt, i thanë, e hazreti Alia r.a., tha:

- Dynjaja është vend që, për hallallin e saj jepet llogari, e për haramin e saj merret dënim.

Malik ibn Dinar ka thënë: *“Dynjaja është një magjistar. Dynjaja magjeps dijetarët, ruajeni veten nga magjia e dynjasë.”*

Ebu Sulejman Darani ka thënë: *“Nëse zemra e njeriut preokupohet me ahiret, vjen dynjallëku dhe kërkon vendin e vet, e nëse zemra e tij preokupohet me dynjallëk, ahireti nuk do të mundohet t'i bëj vetes vend aty, sepse ahireti është fisnik e i ndershëm, ndërsa dynjallëku është tinëzar.”*

Shpresojmë se fjalët e Sejjar ibn Hakemit janë më të drejta: *“Dynjallëku e ahireti janë bashkë në zemër, e cili të dominojë, tjetri i përshtatet.”*

Malik ibn Dinar ka thënë: *“Sa vuan për dynjanë, aq të largohet nga zemra brenga për ahiret, e sa vuan për ahiret, zemra jote largohet nga brenga për dynjallëk.”*

Ashiqare që ibn Dinar është frymëzuar nga fjalët e Alisë r.a., që ka thënë: *“Dynjallëku e ahireti janë dy gra të martuara për një burrë, nëse burri shkon pas njëres – tjetra hidhërohet.”*

Hasan Basriu ka thënë: *“Pasha Allahun, mbaj mend njerëz për të cilët dynjallëku ishte më i pavlerë se pluhuri që ju e shkelni. Ata nuk brengoseshin kur zbardhej e kur bëhej natë, a shkoi dynjallëku andej apo këndeji!”*

Dikush e pyeti Hasan Basriun: *“Çka thua për atë që, Allahu i ka dhuruar pasuri, dhe ky nga ajo pasuri e ndanë sadakanë dhe i ndihmon të afërmit, a është mirë për të që të posedojë atë pasuri?”* Hasani iu përgjigj:

- *Jo, më mirë e ka të mbajë për vete vetëm aq sa i mjafton, e të ndajë gjithë pjesën tjetër.”*

Fudajli ka thënë: *“Sikur e gjithë dynjaja, me të gjitha të mirat e veta të më ishte drejtuar, e për to të mos më kërkohet llogari në ahiret, unë prapë do t’a përbuzja, sikur ju qysh përbuzni një qen të ngordhur kur i kaloni pranë, bile ruheni që as rrobat të mos ju prekë.”*

Kur Omeri r.a., erdhi në Sham, e priti Ebu Ubejde ibn Xherrah në deve me kapistër të thurur. I dha selam, e përqafoi, e më pas e dërgoi në shtëpinë e vet, ku kishte vetëm shigjetën, mburojën dhe shalën. Omeri i tha:

- *Ke mundur të shtrosh diçka në shtëpi, e ai ia ktheu:*
- *O prijës i besimtarëve! Për pushim, kaq mjafton.*

Sufjani thotë: *“Prej dynjasë merr çfarë të duhet për trup, e prej ahiretit merr çfarë të duhet për zemër.”*

E Hasani ka thënë: *“Pasha Allahun, Izraelitët filluan të adhurojnë idhuj, edhe pasi kishin adhuruar Allahun Teala, e krejt për shkak të dashurisë së tyre për dynjanë.”*

Vehb b. Munebbihu tregon se në disa libra ka lexuar: *“Dynjaja është fitim për të mençurit, dhe shkujdesje për budallanë. Ata nuk ia dinë vlerën deri sa t’ju del nga dora. Më pas kërkojnë të kthehet, por nuk u kthehet më.”*

Llukmani i tha të birit: *“O djali jem! Ia ke kthyer shpinën dynjasë qysh atë ditë kur ke ardhur te ajo, e je drejtuar kah ahireti; ti i takon ahiretit që po i afroresh, e je gjithnjë e më larg dynjasë, prej së cilës po ikë.”*

Seid ibn Mesud ka thënë: *“Kur sheh robin që po i shtohen të mirat e kësaj bote e ato të ahiretit po i zvogëlohen, e ai i kënaqur me gjendjen, dije se ai është i mashtruar, e tërheqë dalldia e që ky as nuk e kupton.”*

Amir ibn el-As, sa ishte në minber, tha: *“Vallahi, nuk kam parë askë që më shumë se ju e do atë nga e cila Resulallahu s.a.v.s. përmbahej!*

*Vallahi, nuk kalonin as tri ditë, e Resulallahu s.a.v.s., të mos kishte më shumë vështirësi se sa lehtësi.”*²⁴

Hasan Basriu e lexoi ajetin Kur’anor:

“...mos t’ju mashtrojë jeta e kësaj bote...”

(31: Lukman, 33),

dhe tha: *“Kush thotë kështu?! Thotë Ai që e ka krijuar këtë botë, Ai që më së miri e njeh. Ruajuni mirë nga mashtrimet, sepse dynjaja ka plot mashtrimet. Nëse ju ia hapni një derë mashtrimit, ajo derë bëhet sepse që mashtrimit t’i hapen edhe dhjetë dyer tjera.”*

E Hasani gjithashtu ka thënë: *“Sa i mjerë është njeriu! Kënaqet me botën që për hallallin e saj do të japë llogari e për haramin e saj do të dënohet; nëse merr diçka të dynjasë që i është lejuar, do të pyetet për këtë, e nëse merr diçka që i është ndaluar, do të dënohet. Njeriu gjithmonë mendon se ka pak pasuri, e kurrë nuk mendon se ka pak vepra të mira; dhe frikësohet nga problemet e dynjasë.”*

Hasan Basriu i shkroi Omer ibn Abdulazizit: *“Selamun alejke, ti thua se je i fundit kujt i është shkruar vdekja dhe që ka vdekur”, e Omeri i shkroi si përgjigje: “Selamun alejke, e ti sikur nuk ke qenë në dynja; thua se je gjithë kohën në ahiret.”*

²⁴ Shënon Hakimi, duke e vërtetuar besueshmërinë e tij, e të njëjtë e transmetojnë edhe Ahmed i dhe Ibn Hibban.

Fudajl ibn Ijad ka thënë: *“Në dynja është lehtë të vish, por vështirë është të largohesh prej saj.”*

Dikush pat thënë: *“Çudi ai që beson që vdekja është hak, kënaqet! Çudi ai që beson që xhehenemi është hak, qeshet! Çudi ai që e sheh se dynjaja i shkatërron pasuesit e vet, ndihet i sigurtë në të! Çudi ai që beson që caktimi i Allahut është hak, e brengoset!”*

Një plak dyqind vjeq nga Nexhrani erdhi te Muavia r.a., e ky e pyeti çfarë mendon për dynjanë. Plaku i tha:

- *Disa vite fukarallëk, e disa vite bollëk. Ditë pas dite e natë pas nate, dikush lind e dikush vdes. Po të mos kish lindje krijesat ishin zhdukur, e po të mos kishte vdekje bota do të bëhej e padurueshme për banorët e saj.* Muavia r.a., i tha të kërkojë çfarë të dojë, e ky i tha:

- *Kthema jetën që më ka kaluar, ose ndaloma dakikun e vdekjes që po më vjen.* Muavia i tha:

- *Këtë nuk mund ta bëj!, e plaku i tha:*

- *Atëherë nuk kam nevojë për ndonjë gjë prej teje.*

Davud Ta'i, Allahu e mëshiroftë, ka thënë:

“O njeri! Ti gëzohesh kurtë plotësohen dëshirat, e në fakt i ke paguar me jetën tënde. Dhe ke lënë pas dore veprat e mira, thua se dikush tjetër ka hajr prej tyre.”

Bishri b. Hafi ka thënë: *“Ai që prej Allahut Teala e kërkon dynjanë, është sikur të dëshirojë të japë gjatë llogari para Tij.”*

Edhe Ebu Hazim ka thënë: *“Nuk ka asgjë në këtë botë që të gëzon, e që Allahu Teala nuk i ka shtuar edhe diçka që të dëshpëron.”*

Hasan Basriu ka thënë: *“Shpirti i njeriut e lëshon këtë botë me tri përmallime: nuk është ngopur me atë që e ka grumbulluar, nuk e ka arritur atë që e ka shpresuar dhe nuk është përgatitur për atë që e pret.”*

Një të devotshmi i thanë: *“Ti e arrite pasurinë!”*, e ai u përgjigj: *“Pasanik i vërtetë është ai që është çliruar nga robëria e dynjasë.”*

Ebu Sulejmani ka thënë: *“Sprovat e kësaj bote mund t’i durojë vetëm ai që në zemër ka diçka që e kujton në ahiret.”*

Malik ibn Dinar ka thënë: *“Jemi pajtuar me lidhjen tonë me dynjanë, askush askë nuk e paralajmëron, e kjo gjendje nuk do të vazhdojë kështu. A thua, çfarë dënimi do të na dërgojë Allahu Teala!?”*

Ebu Hadhim ka thënë: *“Edhe pak fitim në dynja, na pengon nga fitimi i shumtë në ahiret.”*

Hasani thotë: *“Mos i jep rëndësi dynjasë, tradhtoje dynjanë.”*

E Hasani gjithashtu e ka thënë edhe këtë: *“Kur Allahu Teala ia do të mirën robit të vet, i dhuron diçka prej dynjallëkut, e pastaj e privon nga kjo, e kur e mira i*

përfundon, prapë ia dhuron. E nëse robi nuk i jep rëndësi dynjallëkut, atëherë Allahu Teala i jep atij me bollëk.”

E dikush ka bërë dua:

“O Allah, që e mbanë qiellin dhe nuk e lejon të bie në tokë, largoje dynjallëkun prej meje!”

Muhammed ibn Munkedir ka thënë: *“Edhe nëse personi vazhdimisht agjëron, netët i kalon në ibadet e nuk fle, pasurinë e vet e jep për sadaka, lufton në rrugë të Allahut e largohet nga harami – prapë në sytë e tij vlerë ka ajo që te Allahu Teala është e pavlerë, ndërsa pa vlerë për të është ajo që te Allahu Teala është me vlerë!” Ibadetet e tij nuk sjellin dobi.”*

Ebu Hadhim ka thënë: *“Vështirësitë e dynjallëkut dhe ahiretit vetëm shtohen. Vështirësia e veprimit të ahiretit është për shkak që nuk mund të gjesh ndihmës, e për ato të dynjasë – kah do që të zgjatësh dorën, do të shohësh që dikush para teje e ka zgjatur dorën andej.”*

Ebu Hurejre ka thënë: *“Dynjallëku është i varur mes qiejve e tokës si lëkurë e tharë dhe e kalbur, që e thërret Rabbën të vet prej se Ai e ka krijuar e deri sa kjo të zhduket:*

- O Rabb! O Rabb! Përse më përbuzë?!, e Allahu Teala i përgjigjet: ‘

Hesht, o ti që je një hiq.”

Abdullah ibn Mubarek ka thënë: *“Dashuria e dynjasë dhe gjynahet i pushtuan zemrat dhe i larguan ato nga mirësia. E si mund tash të pritët hairi?”*

Vehb ibn Munebbih ka thënë: *“Atij që zemra i gëzohet me dynjallëk, e ka humbur urtësinë. Ai që epshet i ka mposhtur, ka larguar shejtanin prej vetes. Atij që dituria ia mund dëshirat, ka arritur fitore.”*

I treguan Bishrit se dikush ka vdekur, e ky tha:

- I grumbulloi të mirat e kësaj bote e shkoi në ahiret, duke e shkatërruar kështu veten.

la numëruan të mirat që i ka bërë, e Bishri tha:

- Ato nuk i'a sjellin dobi, për shkak që ka vrapuar pas dynjallëkut!

Dikush ka thënë: *“Dynjaja na shfaqë armiqësi, e ne prapë e duam. E po të na shfaqte dashuri, çfarë do të bënim!?”*

“Kujt i takon dynjallëku?”, e pyetën një plak të urtë. “Atij që e braktis”, u tha plaku. “E, kujt i takon ahireti?”, pyetën prapë. “Atij që e kërkon”, u përgjigj plaku.

E një tjetër i urtë ka thënë: *“Dynjallëku është si një shtëpi e vogël dhe e rrënuar. E më e rrënuar se kaq është zemra e atij që punon për dynjanë. Xheneti është shtëpi e madhe dhe e ndritshme, e edhe më e ndritshme është zemra e atij që kërkon xhenetin.”*

Xhunejdi ka thënë se Imam Shafiu ka qenë një prej muridëve që kanë folur me gjuhën e të vërtetës në këtë jetë.

E Imam Shafiu, duke e këshilluar një mik, i tha:

“O vëllai im! Dynjaja është teren i rrëshqitshëm dhe vend i poshtërimit. Kush ndërton aty, shtëpia i rrënohet, e kush banon aty, vendbanimi i bëhet varr. Kush lidhet me dynjanë, pasuria i kthehet në varfëri. Në esencë, dynjaja është varfëri, e mospasja është pasuri.

Prandaj, mbështetu në Allahun dhe kënaqu me atë që të ka furnizuar. Mos hyj në borxh në shtëpinë e përherëshme për botën që zhduket, sepse jeta jote është një mur i shtrembër dhe një hije që po zhduket. Puno shumë e shpreso më pak!”

Ibrahim Ed’hem e pyeti një person:

- A e do më shumë një dërhëm në ëndërr apo një dinar kur zgjohesh?”. Ky zgjodhi dinarin e Ibrahim i tha:

- Nuk është e saktë. Ti do në dynja atë që ëndërron. E çka nuk do për ahiret, nuk do as kur je zgjuar.”

Tregohet se Ismail ibn Ajjash ka thënë: *“Shokët tanë dynjanë e quanin derr. Thoshnin: ‘Largohu prej nesh, derr!’ Po të gjenin emërtim më të shëmtuar se ky, atë do ta përdornin.”*

Ka’b ka thënë: *“Dynjaja është bërë për ju aq e dashur, sa që filluat ta adhuroni atë dhe njerëzit e saj.”*

Jahja ibn Muadh er-Razi ka thënë:

“Në tri gjëra njihet i mençuri; kur braktisë dynjanë para se dynjaja ta braktisë atë; kur përgaditet për vdekje para se t’i vjen exheli; dhe kur ai e kënaqë Rabbin e vet, para se T’i dalë përpara.”

Jahja ibn Muadh Razi r.a., gjithashtu ka thënë:

“E keqja e dynjasë ka arritur në atë nivel, që të nxitë të kërkosh gjërat që të largojnë nga ibadeti dhe nënshtrimi Allahut Teala. E njeriu ende dalldiset në këtë dynja.”

Bekr ibn Abdullah ka thënë:

“Ai që mundohet të çlirohet nga dynjallëku me dynjallëk, është si ai që fikë zjarrë me fije kashte.”

Bendari ka thënë:

“Kur ata që janë dalldisurnë dynja të flasin për zuhd e modesti, dje se shejtani po tallet me ta.”

Bendari gjithashtu ka thënë:

“Kush i afrohet dynjasë, zjarri i saj e djegë, e bën hi. E kush i afrohet ahiretit, zjarri i tij e pastron e bëhet shkop prej ari, dhe përdoret për të mirë. Kush i afrohet Allahut Teala, e kaplon flaka e tevhidit e bëhet thesar, me shumë vlerë dhe i çmuar.”

Hazreti Alia r.a., ka thënë:

“Dynjallëku përbëhet nga gjashtë gjëra: ushqim, pije, rroba, mjet transporti, atë që e marton dhe aromat. Ushqimi më i mirë është mjalta, e vjen prej bletës. Pija më e mirë është uji, por e pinë edhe të këqijtë edhe të mirët. Rroba më e mirë është nga mëndafshi, e mëndafshin e prodhon një insekt. Mjeti më i mirë transportues është kali, e ai përdoret edhe për të varë njerëz. Më e mira që e marton është gruaja, e ajo është edhe sprovë mbi sprovat; stoliset në mënyrën më të bukur, por i kërkohet pjesa më e pistë. Aroma më e mirë është miski, e ai është gjak.”

Kapitulli i dytë

CILËSITË E DYNJASË

Dikush pat thënë: "O njerëz, silluni me maturi, dhe keni frikë Allahun! Mos lejoni t'ju mashtrojë shpresa e mos harroni dakikun e vdekjes! Mos iu afroni dynjallëkut, se ai është mashtrues dhe hileqar! Kjo botë zbukurohet për ju dhe ju tërheqë me hijeshi të rreme; ajo zbukurohet për ata që e dëshirojnë, dhe ju shfaqet si nuse e teleisur. Sytë ju drejtohen kah ajo e zemrat mbushen me mall për të. Sa shumë prej atyre që e pasuan ajo i shkatërroi, dhe sa shumë prej atyre që i besuan, ajo i dëshpëroi. Prandaj, mundohuni ta shihni fytyrën e vërtetë të dynjasë, sepse ajo është shtëpi me shumë të meta, që edhe Krijuesi i saj e përbuzë! Gjithçka që në dynja është e re, vjetrohet e humbet; gjithçka që paraqitet me vlerë, nuk ka kurrfarë vlere, gjithçka që është me bollëk, pakësohet; dashuria e saj vdes dhe e mira e saj përfundon. Pra, zgjohuni nga pakujdesi juaj, Allahu ju mëshiroftë, dhe mos vraponi pas dynjasë, e të thuhet për ju: 'Filani është sëmurë', ose edhe: 'Filani është dobët, e a ka ilaç për të?! A ka mjek të aftë për të?!' Dhe ftojnë ndonjë mjek, por nuk ka shpresë për shërim, e pas kësaj thonë: 'Filani la amanetin, dhe e shpërndau pasurinë.' Pas kësaj do të thonë: 'Filanit iu ka trashur gjuha, nuk mund të flasë e as t'i njohë të afërmit.' Atëherë balli të mbulohet nga djersa e të shtohen ofshamat e vdekjes, humbë shpresën, të shtangen kapakët e syve, gjuha trashet, e vëllezërit do të qajnë. Do të të thonë: 'Ky është djali yt, filani', e 'ky është vëllai yt, fisteku'.

Do të shtangesh e nuk do të mund të flasësh, gjuha do të të shtanget dhe nuk do të mund t'a lëvizësh, dhe atëherë zbatohet urdhri i Allahut, dhe shpirti yt ndahet nga trupi, e më pas ngritet në qiell. Atëherë do të mblidhen vëllezërit e tu e të mbështjellin në qefin. Do të gëzohen ata që të kishin lakmi, familja largohet prej teje e i drejtohet pasurisë tënde, e ti do të mbesësh peng i veprave tua.”

Dikush i këshilloi sundimtarët:

“Më së shumti arsye për të përbuzur dynjanë ka ai që ndihet rehat në të e që i janë plotësuar nevojat e kësaj bote; i tilli gjithmonë ka frikë nga fatkeqësia që mund t'i prishë rehatinë e t'i shkatërrojë pronën, ose që ia merr pushtetin, ose nga ndonjë sëmundje, ose që i prishen planet. Dynjaja meriton të qortohet sepse çka dhuron, prapë e merr dhe gjithmonë kthehet për atë që e ka dhënë. I përqeshë pasuesit e vet, dhe i bën të tjerët të qeshin me të, e kur e qajnë të tjerët edhe ajo e qanë, kur jep - shpejtë edhe merr, sot i vendos njeriut kurorë, e nesër e mbulon me dhé. Për dynjanë janë të njëjtë ata që shkojnë me këta që mbesin, sepse ata që shkojnë lënë trashëgimtarët këtu, e për dynjanë këso ndryshimi është i mirëseardhur.”

Kur Omer ibn Abdulaziz u zgjodh halife, Hasan Basriu i shkroi në letër:

“Dije, dynjallëku është shtëpi e përkohshme dhe e udhëtimit, e jo shtëpi e banimit të përhershëm. Ademi a.s., u zbrit në dynja për dënim, prandaj ruaju nga dynjallëku, o prijës i besimtarëve!

Furnizohu në dynja ashtu që do ta braktisësh atë, sepse vërtetë pasuria e kësaj bote është varfëria. Në secilin çast, dynjaja e shkatërron dikë, e përulë atë që e lartëson dynjanë dhe e varfëron atë që grumbullon pasuri. Dynjallëku të është si helm; kush nuk e di këtë, e konsumon, e nga kjo shkatërrohet. Në dynja të jesh si ai që përdor pak ilaç, për shërim.

Prandaj, ruaju nga kjo botë që josh e magjepsë, e që është mashtruese dhe gënjeshtare. Dynjallëku i jep premtime secilit që e pason, dhe është si nuse e teleisur kah e cila drejtohen sytë e zemrat, e njerëzit mbushen me dashuri për të. Dynjallëku përbuzë të gjithë adhuruesit e saj. E përkundër kësaj, njerëzit nuk marrin mësim nga e kaluara e as nuk mendojnë për të ardhmen; askush askë nuk e paralajmëron. Ai që dashurohet në dynja merr nga ajo çfarë i nevojitet, e më pas i rritet mendja e bëhet i padrejtë; e harron ahiretin, e me dynjallëk argëtohet deri sa t'i vijë fundi, dhe mashtrohet keq duke u penduar vetëm kur t'a kaplojnë mundimet e vdekjes. E ka dashtë dynjanë, e as nuk e ka kuptuar se çfarë ka dashur.

Prandaj, o udhëheqës i besimtarëve, ruaju nga dynjaja; të jesh i kujdesshëm, sepse sa herë që i jep rëndësi dynjasë dhe mbanë shpresë në të, ajo të dërgon vështirësi. Ajo që të gëzon në dynja është mashtrim, e ajo që duket sikur sjell dobi, është dredhi dhe sjellë dëm. Jeta e rehatshme në dynja është e lidhur me telashe e fatkeqësi, ndërsa qëndrimi në të sjellë zhdukjen. Çka të gëzon në dynja është e thurur me mjerim, çka shkon nuk kthehet, e as nuk dihet çka vjen, e të përgatitesh. Dëshirat e dynjallëkut janë të rrejshme, shpresat janë të pabaza, çka shihet si e qartë është e turbullt, jeta e mundimshme, e njeriu vazhdimisht

në rrezik nëse jeton me pritje e shpresë; është në rrezik për shkak të të mirave që i jep dynjaja, dhe është në gjendje alarmi për shkak të fatkeqësive dhe telasheve. Po të mos na lajmëronte për rrezikun e dynjasë Krijuesi i saj, Allahu Teala dhe po të mos na jepte shembuj, vet dynjaja do t'i zgjonte gjumashët dhe do t'i tërhiqte vëmendjen të pakujdesshmëve, por Allahu Teala na ka paralajmëruar atëherë kur na e ofroi dynjanë.

Dynjallëku nuk ka kurrfarë vlere te Allahu Teala, dhe Allahu as nuk e ka shikuar prej se e ka krijuar. Pejgamberit tënd, Resulallahut s.a.v.s., i është ofruar dynjaja me gjithë çelësat dhe begatitë e saj, e pranimi i tyre nuk do t'i zvogëlonte atij aspak gradën te Allahu Teala, por Resulallahu s.a.v.s., e refuzoi. Nuk deshi të kundërshtojë Allahun Teala dhe nuk deshi që të dëshirojë atë që Krijuesi i tij e përbuzë, e as të lartësojë atë që Rabbi i tij ka përlulur. Allahu i largoi robët e Tij të mirë nga dynjallëku, që me këtë t'i sprovonjë, e dyert e dynjasë ua hapi armiqve të Tij, që me këtë t'i joshë. Ai që është i mashtruar, dhe posedon diçka prej dynjasë, mendon që është më i mirë e më fisnik, ndërsa harron se Muhammedi s.a.v.s., nga uria ka lidhë gur në stomak!

Resulallahu s.a.v.s. tregon se Allahu Teala i tha Musasë a.s.:

“Kur sheh se pasuria po të afrohet, thuaj: ‘Je gjynah që e shpejton dënimin’, e kur sheh se varfëria po të afrohet, thuaj: ‘Mirë se vjen, oj shenjë e njerëzve të mirë’.

Nëse do, merr mësim prej Isasë a.s., të birit të Merjemit a.s., që ka thënë:

“Udhëzuesi im është uria, rroba ime është leshi, ngrohja ime është dielli, drita ime është Hëna, transporti im janë këmbët e mia, ushqimi im rritet nga toka, flej e zgjohem pa poseduar gjë, e në gjithë botën nuk ka më të pasur se unë.”

Vehb ibn Munebbih tregon: “Kur Allahu Teala i dërgoi Musanë dhe Harunin, (a.m.s.), te faraoni, u tha:

‘Mos të ju habisin rrobat e faraonit, që janë frut i të mirave të kësaj bote, sepse shpirti i tij është në dorën Time; ai nuk mund të flasë, as të lëvizë qerpikun, as të marrë frymë - pa lejen Time. Mos të ju habisë kënaqja e tij me të mirat e kësaj bote, sepse ajo është vetëm kënaqje në dynjallëk dhe zbukurim i atyre që e teprojnë. Po të doja, do t’ju zbukuroja me stoli të kësaj bote, që faraoni do t’i njihte e do ta dinte se ai vet nuk mund t’i bëjë ato. Por Unë nuk e dua këtë për juve, prandaj edhe ju kam privuar nga to, e njëjtë i kam privuar edhe robët e Mi të mirë (evliatë); Unë ata i largoj nga kënaqja në këtë botë sikur çobani i kujdesshëm që e largon kopenë nga kullosat e rrezikshme. Ata për Mua zbukurohen me përulësi, me frikë-respekt dhe nënshtrim; frikë-respekti rritet në zemrat e tyre dhe shfaqet në trupin e tyre; ajo është rroba që ata e veshin, mbështjellës i tyre, është vetëdije që ata e ndjejnë, sukses i tyre me të cilin fitojnë, është pritja e tyre për të cilën shpresojnë, nami që i lartëson, është shenja e tyre sipas së cilës njihen.

Kur i takon, shpreh mirësi dhe butësi ndaj tyre, gjuhën dhe zemrën tënde vëri në shërbim të tyre, sepse ta dish: kush e frikëson robin Tim të mirë, (evlianë) më ka shpallur luftë Mua, e në Ditën e Gjykimit për të hakmirrem Unë.”

Hazreti Alia r.a., në një hutbe ka thënë:

“Ta dini sigurtë që do të vdisni, e do të ringjalleni pas vdekjes, e do të përgjigjeni për veprat e juaja, e do të dënoheni ose shpërbleheni! Prandaj mos t’ju mashtrojë jeta në këtë botë! Kjo jetë është e mbushur me telashe, njihet për përkohshmërinë e vet, dallohet me mashtrimin e vet, gjithçka në të është kalimtare, kalon herë te një adhurues i saj e herë te tjetri, gjendjet e saj nuk zgjasin e banorët e saj nuk mund të mbrohen nga të këqijat e saj. Ata që jepen pas jetës në këtë botë jetojnë në rehati e kënaqësi, e përnjëherë i sheh në telashe e fatkeqësi, gjendjet ju ndryshojnë shpesh. Jeta në këtë botë është e përbuzur, e rehatia është kalimtare; ata që jepen pas dynjasë, vetëm se bëhen cak për shigjetat e saja vdekjeprurëse, e vdekja në këtë botë është e caktuar, si edhe hisja në të. Dijeni o robë të Allahut, që ju dhe gjendjet tua në këtë botë janë rruga kah kanë ecur edhe ata para jush e që jetonin më gjatë se ju, ishin më të fortë se ju dhe kanë lënë gjurmë më të thella; e zërat e tyre u heshtën trupat u janë kalbur, vendbanimet u janë boshatisur, gjurmët u janë humbur. Ndërtesat e tyre dhe rehatinë në to e ndërruan me gurë e shkëmb, në varrin e ultë e të ngushtë. Ai është vend ku të gjithë shkojnë, ndërsa secili është i huaj, sepse secili merret me veten e nuk i vëren banorët e ri; nuk vizitohen mes vete si vëllezërit e komshitë, ani pse janë aq afër njëri-tjetrit. Si të vizitohen, kur i ka

mbuluar telashja me peshën e saj të rëndë e i kanë ngrënë gurët e shkëmbinjtë. Pasi që e jetuan jetën, tash janë të vdekur; pas jetës së rehatshme u shndërruan në mbetje mortore që frikësojnë edhe miqtë e tyre, janë vendosur të banojnë nën dhé e janë nisur në rrugë pa kthim. Larg qoftë! Larg qoftë! E Allahu Teala thotë:

“Kurrsesi, (kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde, deri në ditën kur ringjallen.” (23-Muminun: 100)

Eh sikur të ishte e mundur të shihnit me sytë tuaj se si ngjallet çka ka në varreza, si del në shesh çka ka në gjokse kur zemrat shpërthejnë nga dhimbja e gjynaheve të bëra, kur të ngriten perdet e pengesat dhe të zbulohen turpi dhe fshehtësitë, si qëndrojnë para Allahut Teala për të dhënë llogari për veprate bëra, e si atëherë secili do të marrë atë që ka merituar. Allahu Teala thotë:

“Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë, për t’i dënuar ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta e, për t’i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me shpërblimin më të mirë.”(53-Nexhm: 31),

dhe thotë:

“Dhe Libri do t’u vihet përpara, e do t’i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të.”(18-Kehf: 49)

Pra mendoni për këto. Neve dhe juve Allahu Teala na bëftë prej atyre që veprojnë ashtu siç e thotë Libri i Tij, dhe që pasojnë robët e Tij të sinqertë, dhe me mirësinë e Tij, të na vendosë në Xhenet. Vërtetë i Lavdëruar dhe i Madhëruar është Ai.”

E një i urtë ka thënë:

“Ditët janë shigjeta e njerëzit janë caku i tyre, ndërsa koha është shigjetari. Secilën ditë koha të gjuan me shigjetat e veta duke të shkatërruar me ditët dhe netët e saj, deri sa nuk shkatërrohesh plotësisht.

E si mund të mbetesh shëndosh e rehat kur ndërrohen dita me natën?! Sikur të tregoja se çfarë dëmi i kanë bërë ditët e kaluara trupit tënd, do të frikësoheshe për secilën ditë të re, e do të dëshiroje që sahati të lëvizë më ngadalë. Por, përcaktimi i Allahut është mbi të gjitha.

Kënaqësia e dynjasë gjendet në shpëtimin nga gajlet; në fakt dynjaja është në një gjendje ilaçi, është më i idhët se pelini. Njeriu nuk është në gjendje të përshkruaj të këqijat e dynjasë për shkak të gjithë asaj që mund të haset tek ajo, e as vazi nuk mund të tregojë të gjitha befasishtë dhe fshehtësitë e pazakonta të saj. O Allah, udhëzoni në rrugë të drejtë dhe mos na devijoni nga rruga e drejtë!”

Duke e përshkruar dynjanë, një i urtë ka thënë:

“Dynjallëk është koha sa qelet e msholet syri, sepse koha që ka kaluar nuk kthehet, e atë që vjen ti nuk e njeh. Koha, në fakt është dita për të cilën vajton nata që po vjen dhe minutat që e përbijnë; ngjarjet renditen njëra pas tjetrës duke i sjellë njeriut ndryshim e pakësim.

Koha është përgjegjëse për shpërbërjen e bashkësive dhe për ndarjen mes të afërmeve. Shpresa është e fortë, e jeta në këtë botë është e shkurtë dhe, në fund, gjithçka kthehet te Allahu.”

Omer ibn Abdulaziz r.a., në një hutbe ka thënë:

“O njerëz! Ju vërtetë jeni krijuar për një arsye; nëse e besoni këtë, ju shohin si të humbur, por nëse këtë e mohoni, shkatërroheni. Jeni të krijuar për përjetësi, dhe vetëm kaloni nga një botë në tjetrën.

O robë të Allahut! Jeni në dynja, e keni aq shumë ushqim e pije, sa ngulfateni. E sa herë të ju vjen një e mirë, një tjetër ju braktisë, e ju do të donit të mos ishte ashtu.

Prandaj, veproni ashtu që të keni dobi në botën në të cilën jeni duke shkuar, e ku do të qëndroni përgjithmonë.”

Në atë moment Omeri filloi të qajë dhe zbriti nga minberi.

Hazreti Alia r.a., në një hutbe ka thënë:

“Ju këshilloj devotshmërinë dhe të braktisni dynjanë, siç ju ka braktisur ajo juve, ani pse ju nuk dëshironi ta braktisni!

Ju këshilloj të braktisni dynjallëkun që ju shkatërrojnë trupat, e ju vazhdoni t’i ripërtërinë ata! Rasti juaj me dynjanë është sikur rasti i udhëtarit që shkon rrugës duke menduar që është gati të mbërrijë në cak, ndërsa as nuk e di se edhe sa rrugë ka. Kush e di sa ka të tillë që ju ka mbetur vetëm edhe një ditë, e ata me ngulm vazhdojnë t’a përdorin atë deri sa nuk ndahen prej dynjasë.

Mos keni frikë nga vështirësitë dhe telashet e kësaj bote sepse ato kanë fund, e as mos u gëzoni me të mirat e saj, sepse edhe ato përfundojnë. Habitem me atë që e do këtë botë, ndërsa atë e do vdekja. Habitem me atë që është në gaflet, deri sa vdekja nuk është në gaflet ndaj tij.”

Muhammed ibn Husejn ka thënë:

“Të mirët, dijetarët, arifët dhe robët e edukuar të Allahut e kanë kuptuar që Allahu Teala e ka krijuar dynjallëkun të pavlefshëm.

Ata e kuptuan që Allahu Teala nuk ia dëshiron dynjanë robëve të Tij të sigurtë, që dynjaja është e përbuzur tek Allahu, që Resulallahu s.a.v.s. plotësisht e ka injoruar dhe u ka tërhequr vërejtjen as’habëve për sprovat e saj.

As’habët merrnin nga dynjaja vetëm aq sa u mjaftonte, braktisnin atë që i largonte nga Allahu Teala, visheshin aq sa të fshehin pjesët e turpshme, ushqeheshin aq sa u të zbrapsin urinë, e dynjanë e shihnin si diçka që e ka fundin e vet, deri sa ahiretin e shihnin të përjetshëm.

Prandaj ata nga dynjallëku merrnin atë që do t’ju ndihmonte në rrugë për ahiret dhe vepronin atë që në ahiret ju sjell dobi. Ahiretin e shikonin me zemër, duke e ditur se do ta shohin edhe me sytë e tyre. Në ahiret shkonin me zemër, duke e ditur se atje do të shkojnë edhe me trup. Me pak durim, arrijnë në kënaqësi të gjatë, e krejt kjo me ndihmën e Rabbit të tyre.

Ata donin atë që Allahu Teala u thotë se është e mirë për ta, ndërsa përbuznin atë që Allahu Teala u thotë se nuk është e mirë për ta. Edhe ju doni atë që Allahu do për ju dhe përbuzni atë që Ai e përbuzë.”

Kapitulli i tretë

KRAHASIMET E DYNJASË

Dije se kjo botë po zhduket me shpejtësi, fundi është shumë afër. Dynjaja të premtot përjetësi, por nuk e mbanë premtimin.

Kur shikon dynjanë, mendon se është e qëndrueshme, por ajo në fakt ndryshon vazhdimisht dhe rrjedhë me shpejtësi. Fatëkeqësisht, ai që e shikon dynjanjë, nuk e ndjenë lëvizjen e shpejtë të saj, dhe i mbështetet asaj. E kupton vetëm kur vjen fundi, e atëherë është vonë.

Dynjaja është si hija, që në dukje është e palëvizshme, por në esencë ajo është në lëvizje.

Kur e pyetën Hasan Basriun për dynjanë, ai u përgjigj me këtë poezi:

*"Është si ëndrra në gjumë, a si hije e që kalon;
sigurisht që të mençurin kjo nuk e mashtron."*

Hasan ibn Ali ibn Ebu Talib r.a., shpesh jepte shembuj, e një herë pat thënë:

*"O ju që gëzoheni me hijeshitë e kësaj bote,
hijeshi është kjo që nuk vazhdon,
Budallallëk është të mashtrohesh,
me një hije që kalon."*

E thuhet se këto vargje hazreti Hasani r.a., i ka marrë nga një beduin.

Tregohet se një beduin erdhi në vizitë te një fis. Ata e gostitën dhe e ushqyen, e më pas beduinin e zuri gjumi dhe shkoi nën hije të çadrës së tyre të flejë. Më vonë, ata e ngritën çadrën. Kur Dielli e goditi beduinin, ky u zgjua, u ngrit në këmbë, e tha:

*Kjo dynja është si hije e çadrës në oazë,
sigurisht vjen një ditë, e hije s'ka me pasë.*

Gjithashtu, një poet ka thënë:

*Atij që dynjaja i është bërë qëllimi më i dashur,
Ai është ngjitur për një konop të kalbur.*

Me fjalë të tjera, dynjaja është mashtruese e pabesë dhe përngjanë në ëndërr, që kur zgjohesh nuk mbetet gjë. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kjo botë është ëndërr, e të dashuruarit pas saj do të shpërblehen ose dënohen për të.”

Junus b. Ubejd ka thënë: *“Vetja në këtë botë më duket sikur ai që është në gjumë e në ëndërr sheh ato që pëlqen e ato që përbuzë, dhe përnjëherë zgjohet. Ashtu edhe njerëzit janë disi në gjumë, e kur të vdesin do të zgjohen pa atë të cilës i gëzoheshin dhe të shohin që i mbanin shpresat në ëndërr.”*

E pyetën një plak se në çka përgjanë dynjallëku, tha: *“Në ëndrën e personit në gjumë.”*

Dynjallëku është armik i pasuesve të vet dhe i shkatërron ata

Dije se është tabiati kësaj bote që fillimisht të përkëdhelë e pastaj të shkatërron. Ajo është si nusja që stoliset për dhëndrin, e pas martesës e shkatërron atë.

Isasë a.s., dynjaja iu shfaq në formë të një plake pa dhëmbë, stolitur me stoli të bukura. Isa a.s., e pyeti:

- *Sa herë je martuar?*, e ajo u përgjigj:
- *Aq shumë sa as numrin nuk ua di.*
- *A kanë vdekur të gjithë, apo të kanë braktisur?*
- *Jo, I kam mbytë të gjithë, e Isa a.s., i tha:*
- *Mjerë për burrat e tu të ardhshëm! Si nuk mësojnë prej fatit të atyre që kanë kaluar më herët? Ti i shkatërron një nga një, e ata nuk largohen prej teje?!*

Pamja e dynjasë nuk i përshtatet brendisë së saj

Dije se pamja e jashtme e kësaj bote është e zbukuruar por brendinë e ka të shëmtuar. Përngjanë në plakë të veshur me rroba të shumëllojshme; që i mashtron njerëzit me pamjen e jashtme, por kur njerëzit shohin më afër dhe ia heqin maskën prej fytyrës, atëherë ju shfaqet krejt shëmtia dhe pendohen pse kanë shkuar pas saj, e turpërohen sa naivë kanë qenë duke lejuar t'i mashtrojë pamja e jashtme.

Alâ b. Zijad tregon: “Pashë në ëndërr një shtrigë plakë, që kishte lëkurë të rrudhur e ishte stolitur më të gjitha stolitë e botës. Njerëzit u mbledhën rreth saj duke e shikuar me admirim. U afrova edhe unë dhe u habita si e shikonin njerëzit dhe pse ishin mbledhur. I thashë asaj:

- Kush je ti?, e ajo ma ktheu:

- A nuk më njeh mua?

- Jo, nuk e di kush je, i thashë unë, e ajo tha:

- Unë jam dynjaja.

- Allahu Teala më mbrojti nga sherri yt!, i thashë, e ajo ma ktheu:

- Nëse do të ruhesh nga sherri im, përbuz dërhemim.”

Ebu Bekr b. Ijjash po tregonte: “Në ëndërr, dynjanë e pashë në formë të një plake të shtrembëruar e të thinjur që duartrokiste, e plot njerëz i shkonin pas, duke vallëzuar. Kur erdhi te unë, m’u afrua, e më tha:

- Po të kisha mashtruar ty, edhe ti do të kishe vallëzuar si këta. Atëherë, Ebu Bekr filloi të qajë, e tha:

- Këtë e pashë para se të vij në Bagdad.”

Fudajl b. Ijad transmeton që Ibn Abbas r.a., ka thënë: “Në Ditën e Gjykimit dynjaja do të vijë në mahsher në formën e një plake të thinjur, të verbër, me sy të kaltër, pa dhëmbë e me fytyrë të shtrembëruar: Njerëzit do të pyeten:

- A e dini kush është kjo?

- Allahu na ruajtë! As nuk duam ta dimë!, do të thonë ata, e do t’u thuhet:

- Kjo është dynjaja, për të cilën keni luftuar, për të cilën keni braktisur të afërmit, për të cilën keni pasur lakmi dhe

keni urrejtë njëri-tjetrin, e jeni mashtruar. Pastaj dynjaja hudhet në xhehenem, e nga atje do të thotë:

- O Rabbi im! Ku janë ata që më pasuan e më ndihmuan?!, e Allahu Teala do të thotë:

Dërgojani edhe ata që e pasuan dhe e ndihmuan.”

Fudajl ka thënë:

“Kam dëgjuar se një person ka parë në ënderr një grua të zbukuruar e të stolisur, e që lëndonte secilin që i kalonte rrugën. Kur largohej, dukej si diçka më e bukur që njerëzit ndonjëherë kanë parë, e kur afrohej dukej si diçka më e shëmtuar që njerëzit ndonjëherë kanë parë. Personi i tha:

- Allahu më mbrojtë prej sherrin tënd!, e ajo ia ktheu:

- Jo pasha Allahun, Allahu nuk të mbronë prej sherrit tim përderisa ti nuk përbuzë dërhemin!

Ky e pyeti:

- Kush je ti?, e ajo u përgjigj:

- Jam dynjaja.

Dynjaja është stacion kalimtar

Dije se ekzistojnë tri gjendje të cilat njeriu i kalon: e para është koha kur njeriu nuk ka qenë asgjë, koha para ekzistimit të tij. Koha e dytë është kur njeriu nuk do ta shohë më dynjanë - koha pas vdekjes, që është edhe koha e përhershme. Koha e tretë është mes dy të parave, pra në mes të para-ekzistimit dhe të përhershmes, e këto janë ditët e jetës tënde në këtë botë. Mendo se sa të zgjasin këto ditë në krahasim me dy kohët tjera, e do të kuptosh se është sa një hap i vetëm në një rrugëtim të gjatë.

Prandaj Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Unë nuk kam asgjë me dynjanë! Sepse në dynja unë jam sikur udhëtari në ditë me diell që mbërrinë te ndonjë pemë; pushon një moment në hijen e saj, e pastaj vazhdon udhëtimin.”²⁵

Kush e sheh me këtë sy dynjanë, ai nuk mbështetet në të dhe nuk mërzhitet që i kalojnë ditët, qoftë në vështirësi e varfëri, apo në bollëk e luks. Një person i tillë nuk vendos as një qerpiç mbi tjetrin ngase edhe Resulallahu s.a.v.s., kaloi në ahiret, pa vendosur një qerpiç mbi një qerpiç tjetër.

Resulallahu s.a.v.s, njëherë e pa njërin prej as’habve duke ndërtuar shtëpi me material të fortë dhe këtë veprim nuk e miratoi. Edhe isa a.s., ka thënë: *“Dynjaja është një urë. Kalojeni, por mos e ndërtoni.”*

Ky është një shembull shumë i saktë e i qartë, sepse dynjaja është një urë që sjell në ahiret. Filimi i kësaj ure është djepi, e fundi është varri. Distanca në mes është e kufizuar. Disa e kanë kaluar gjysmën e urës, disa një të tretën, disa dy të tretat, e disave ju ka mbetur vetëm edhe një hap, e as nuk janë të vetëdijshëm për këtë. Sido që të jetë, secilit i duhet t’a kalojë këtë urë, e të ndërtohet mbi të dhe të zbukurohet ura deri sa duhet patjetër ta kalojmë, paraqet kulmin e injorancës dhe budallallëkut.

²⁵Shënon Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Hakimi, nga Ibn Mesud. E shënojnë edhe Ahmedi dhe Hakimi, që e vërteton edhe me hadith nga Ibn Abbasi.

Hyrja në dynja është e lehtë por dalja nga ajo është e zorshme

Dije se fillimi i dynjallëkut duket i butë dhe i lehtë; ai që hyn në të mendon se ëmbëlsia e dynjasë vazhdon, e është larg prej saj. Pra, të lëshohesh në dynjallëk është e lehtë, por të shpëtosh prej saj është tepër e vështirë. Hazreti Alia r.a., i shkroi Selman Farisiut:

“Kjo botë është si gjarpri: i butë kur e prekë, por me helm vdekjeprurës. Prandaj, largohu prej kënaqësive të saj që ajo të mos afrohet ty. Bregat e dynjasë ndërroi me bindjen se do ta braktisësh atë, dhe bëhu i lumtur, por edhe i kujdesshëm, sepse sa herë që njeriu e harron veten në kënaqësitë e kësaj bote, e godet ndonjë fatkeqësi. Vesselam.”

Shpëtimi nga barra e dynjasë është i vështirë

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush dalldiset nëdynjallëk është sikur personi që ecë në ujë; si mundet të mos i lagen këmbët?”²⁶

Ky hadith po të tregon për injorancën e atyre të cilët me trupat e tyre janë dalldisë në kënaqësitë e dynjallëkut, duke menduar se zemrat do t’ju mbesin të pastra e të ruajtura, dhe që veprat e tyre nuk do të lënë gjurmë në të brendshmen e tyre. Ky është kurth i shejtanit. Por të tillët, nëse i largoni nga ato kënaqësi, do të jenë njerëzit që më shumti vuajnë. Ashtu siç ecja në ujë që gjithsesi i lagë

²⁶ Ibn Ebi’ d-Dyn’ja, dhe Bejhekiu nga Hasani, e ka edhetransmetues të tjerë.

këmbët, edhe kënaqësitë e kësaj bote gjithsesi që sjellin errësirë në zemra dhe forcojnë lidhjet e tyre me dynjallëkun, ndërsa varshmëria e zemrës për dynjallëk pengon përjetimin e vërtetë të ibadetit. E Isa a.s. ka thënë:

“Unë po ju them hakikatin: sikur i sëmuri kur shikon ushqimin në pamundësi ta shijojë për shkak të dhimbjeve, edhe personi i dhënë pas dynjasë nuk mund të kënaqet në ibadet e as t’ia shijojë ëmbëlsinë për shkak të dashurisë për dynjanë që bartë në zemër.

Prapëpo ju them hakikatin: nëse kali nuk përdoret për shalim dhe nuk edukohet, ai bëhet i vështirë për t’u kontrolluar dhe ndërron vesin; edhe zemrat që nuk zbuten me kujtim të vdekjes e me ibadet – ngurtësohen e ashpërsohen. Prapë po ju them: nëse lëkura e terur nuk është e shpuar ose e tharë ajo mund të bëhet enë për mjaltë; edhe zemra - nëse nuk e grisin epshtet, nuk e ndotë lakmia e nuk e ngurtësojnë kënaqësitë e dynjasë, bëhet enë për urtësi.”

E Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Në dynja kanë mbetur belaja dhe fitneja (ngatërresat), e veprat tuaja janë si enë; nëse janë të pastra në pjesën e epërme, janë të pastra edhe në pjesën e poshtme, e nëse pjesa e epërme është e përlyer, edhe pjesa e poshtme është e përlyer.”²⁷

²⁷ Shënon Ibn Maxhe nga Muaviu, ndërsa transmetuesit i ka të besueshëm (sikat).

Prej dynjasë ka mbetur edhe pak, në krahasim me të kaluarën

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kjo botë është sikur rroba e cila është e shqyer prej majes deri poshtë e mbahet bashkë me fijen e fundit; ajo fije vetëm sa nuk është këputur.”²⁸

Lidhjet e kësaj bote mund të qojnë në shkatërrim

Isa a.s., ka thënë:

“Ai që jepet pas dynjasë është si ai që pi ujë nga deti – sa më shumë të pijë vetëm se i shtohet etja, e në fund nga ai ujë shkatërrohet.”

Fillimi dhe fundi i dynjasë nuk janë njëjtë

Dije se epshet e dynjasë janë të shijshme për zemrën sikur ushqimi për lukthin. Secili rob para vdekjes do të ndjejë në zemër përbuzje e neveri ndaj kënaqësive të kësaj bote, bash ashtu siç ndjenë përbuzje kur ushqimi i shijshëm ia mbushë lukthin. Sa do që ushqimi të jetë i shijshëm, jashtëqitja e mbetjeve të saj është e fëlliqur. Ashtu është edhe me epshet e dynjasë me të cilat njeriu kënaqet e ëmbëlsohet, në vdekje ato janë neveritëse e të shëmtuara. Zaten, kjo mund të shihet edhe në jetën në këtë botë: sikur dikujt do t’i plaçkitnin shtëpinë, do t’i rrëmbenin fëmijët e familjen dhe do t’i merrnin pronën, dhimbja e tij për ato që

²⁸ Shënon Ebu’sh-Shejh, Ibn Hibban dhe Bejhekiu nga Enesi

ka humbur do të ishte e barabartë me lidhjen që e ka pasur me to, dhe brengën e dashurinë e tij ndaj tyre. Sa më i lidhur të jetë njeriu për dikë apo diçka, aq më e vështirë do ta ketë kur t'i humbasë ato. Vdekja nuk është tjetër pos humbje e asaj që është në dynja.

Tregohet se Resulallahu s.a.v.s., e pyeti Dahhak ibn Sufjan Kullabiun:

- A je ti ai që hedh erëza dhe krip në gjellë, e kur ha më pas pi edhe qumësht edhe ujë?

- Unë jam, tha Dahhaku. Resulallahu s.a.v.s., pyeti:

- Në çka shndërrohet gjithë ajo?

- Kjo është e ditur, u përgjigj Dahhaku, e atëherë Resulallahu s.a.v.s., tha:

- Pra, Allahu Teala e ka përngja fundin e dynjasë me fundin e ushqimit të njeriut.²⁹

Sipas Ubejj ibn Ka'b, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Vërtetë dynjaja i është dhënë njeriut si shembull, prandaj shih çfarë del nga njeriu; qoftë ushqim i ëmbël apo me mëlmesa, njëjtë - shih në çka shndërrohet!”³⁰

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Vërtetë Allahu e ka përngja dynjanë me ushqimin e njeriut dhe ushqimin e njeriut me dynjanë; ëmbëlsuar dhe mbushur me mëlmesa.”³¹

²⁹ Shënojnë Ahmedi dhe Taberani nga Dahhaku

³⁰ Shënojnë Taberani dhe Hibban, si edhe Abdullah ibn Ahmedi në veprën ‘*ez-Zijadat*’.

³¹ Pjesa e parë e hadithit është garib, e pjesa e dytë është e shënuar në hadithin e Dahhak ibn Sufjan.

Hasan Basriu ka thënë: *“Kam parë se si njerëzit shtojnë mëlmesa dhe erëza të ndryshme në ushqim, e më pas e hudhin, atje ku ti e di.”*

Allahu Teala thotë:

“Le të mendojë njeriu për ushqimin e vet.”

80-Abese: 24

E edhe Ibn Abbasi r.a., ka thënë:

“Le të shikojnë përfundimin e ushqimit.”

Një person i tha Ibn Omerit r.a.,:

- *Desha të të pyes diçka, por më vije turp.*

- *Mos u turpëro e pyet, i tha Ibn Omeri, e ky tha:*

- *Kur dikush e bën nevojën, e më pas e shikon...Ibn*

Omeri r.a., i tha:

- *Po. Atëherë këtë e shikon meleku dhe thotë:*

“Shiko përfundimin e ushqimit, në çka është shndërruar!”

Bishr ibn Ka’b tha:

“Ejani t’ju tregojë dynjallëkun!”; i dërgoi njerëzit te mbeturinat, e ju tha:

- *Qe, ky është fundi i dynjajsë.*

Krahasimi i dynjasë me ahiretin

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Në krahasim me ahiretin kjo botë është sikur të fusësh gishtin në det; e shih se çfarë nxjerrë me këtë!”³²

³² Shënon Muslimi nga Mustevrid ibn Sheddad.

Shembull se si njerëzit argëtohen në dynja dhe harrojnë ahiretin, e për këtë shkak humbasin shumë

Dije se njerëzit e dhënë pas dynjasë janë si njerëzit në anijen që ndalet në ishull e kapetani i lëshon për të kryer nevojën, por ju tërheq vërejtjen të mos vonohen, sepse anija mund të largohet.

Disa nguten e kthehen në anije dhe i marrin vendet më të mira, e disa qëndrojnë në ishull duke shijuar peizazhin e bukur, fushat e malet, lulet e bukura, shkurret e gërshetuara e cicërrimën e zogjëve, e më pas vërejnë edhe gurë e metale të çmuar që tërheqin shikimet, e këta mahniten me format dhe ngjyrat e tyre. Pastaj, përnjëherë ju kujtohet anija e nguten mbrapa, por ju mbesin vendet e ngushta e të papërshtatshme.

Disa prej tyre jepen pas gurëve të çmuar dhe për shkak të bukurisë së tyre, nuk mund t'i lënë, prandaj i marrin disa me vete, e pastaj kthehen në anije. Por ju mbesin vendet edhe më të ngushta, e atë që e kanë marrë edhe më shumë kjo ju bëhet barrë e rëndë; pendohen që i kanë marrë ata gurë me vete por nuk mund t'i hedhin e as të gjejnë vend t'i lëshojnë; i mbajnë e pendohen pse i kanë marrë, por pendimi nuk u jep dobi.

Të tjerët dalldisen mes gjelbërimit të ishullit, e harrojnë anijen dhe largohen duke shëtitur e duke u kënaqur, bile nuk dëgjojnë as thirrjen e kapetanit të anijes, sepse janë thelluar në ngrënien e fryteve dhe në kënaqje me bukuritë e ishullit, ani pse janë të vetëdijshëm për rrezikun nga bishat e egra dhe telashet tjera; janë të vetëdijshëm që therrat mund t'ju grisin rrobat, që ndonjë degë mund t'i gërrithë, që ndonjë xhemb mund t'ju ngulet

në këmbë, që ndonjë zë i tmerrshëm mund t'i shashtisë, që therrat mund t'ju shkyejnë rrobat e t'ju zbulojë fshehtësitë, e nuk mund të ecin tutje. E kur të dëgjojnë thirrjen e fundit nga anija, nisen të kthehen me krejt atë që kanë mbledhur e në anije nuk gjejnë vend, prandaj mbesin në ishull dhe shkatërrohen.

Ka edhe të tillë që nuk e dëgjojnë fare thirrjen e anijes dhe anija largohet; disa prej tyre i shqyejnë bishat, të tjerët vazhdojnë të ecin deri sa të rrëzohen e vdesin, disa vdesin në mundime, disa i sulmojnë gjarprinjtë, e nga ta mbesin vetëm kufomat e shpërndara nëpër ishull. Ata që janë kthyer në anije me ngarkesë nga ishulli e janë penguar, në anije u bëhet shumë ngushtë; luleve që i kanë mbledhur shpejt u thahen ngjyrat e gurët e çmuar zbehen dhe fillojnë të lëshojnë erë të rëndë. U mbetet vetëm t'i hedhin në det e kështu të çlirohen; ndërsa ajo që kanë ngrënë në ishull ndikon në shëndetin e tyre e sëmuren pa mbërri në destinacion. Ata që nuk qëndruan gjatë në ishull i shqetëson vetëm tollovia në anije, por kjo kalon sapo të përfundojë udhëtimi e të largohen nga anija, ndërsa ata që janë kthyer të parët e që kanë gjetur vend të mjaftueshëm në anije, kthehen në shtëpi shëndosh e mirë.

Kështu është rasti me ata që jepen pas dynjallëkut për të grumbulluar pasuri për vete, duke harruar nga kanë ardhur e ku po shkojnë. Sa gjykim i shëmtuar i atyre që thonë se janë të mençur e të dijshëm, ndërsa i lejojnë vetes të mashtrohen me ar e argjend e me zbukurime të kësaj bote; vuajnë e brengosen për to, e asgjë prej tyre s'mund të marrin me vete, bile do t'ju bëhen barrë e rëndë e fatkeqësi. Kjo është gjendja e njerëzve, përveç atyre që Allahu Teala i mbronë.

Shembull se si mashtrohen njerëzit me dynjallëk dhe si kjo ju dobëson imanin

Hasan Basriu tregon se ka dëgjuar që Resulallahu s.a.v.s., ju ka thënë as'habëve të tij:

- Unë, ju dhe shembulli i dynjasë jemi sikur një grup njerëzish që u nisën në udhëtim shtigjeve të shkretëtirës e arrijtën deri aty ku nuk e dinin a janë në gjysmë të rrugës, ndërsa ushqimin e kishin hargjuar. Pa ushqim, ata mbetën në mes të shkretëtirës në gjendje të mjerë. Atëherë ju paraqit një njeri me rroba të bukura e me kokë të lagur. Këta thanë: *“Ky sapo është larguar nga ndonjë vendbanim; ai ka mundur të vijë vetëm nga ndonjë vend i afërt.”* Kur u afrua, ai ju tha:

- *O njerëz, e këta u përgjigjën:*

- *Po të dëgjojmë. Ai i pyeti:*

- *Çfarë ka ndodhur me ju?, e ata i thanë:*

- *Po e sheh edhe vet. Personi ju tha:*

- *Çfarë do të bënit po t'ju tregoja rrugën deri te uji i pijshëm e gjelbërimi?, e këta i thanë:*

- *Kurrë nuk do të kundërshtonim.*

- *Mirë - tha personi, - por më premtoni e betohuni në Allah që ashtu do të veproni. Më pas i dërgoi te uji i pijshëm dhe gjelbërimi e qëndroi me ta, aq sa deshti Allahu, e më pas ju tha:*

- *O njerëz, e këta u përgjigjën:*

- *Urdhëro, e ky ju tha:*

- *Është koha për udhëtim. E pyetën:*

- *Kah?, e personi tha:*

- *Drejt ujit që nuk është si uji juaj, dhe drejt gjelbrimit që nuk është si gjelbrimi juaj. Shumica prej tyre thanë:*

- Ne askund nuk do të gjejmë atë që gjetëm këtu; askund nuk do ta kemi jetën më të mirë se këtu. Disa prej tyre, që ishin më pak në numër, thanë:

- A nuk i premtuat njeriut e u betuat në Allah se nuk do ta kundërshtoni kurrë. Deri tash, ai e mbajti premtimin e vet, e pasha Allahun, do ta mbajë deri në fund. Këta shkuan pas personit, e ata që mbetën shpejt i sulmoi armiku; disa i vrau e disa i robëroi.³³

Shembull se si është dhimbja e ndarjes nga të mirat e dynjasë

Dije se ata që u janë dhënë të mirat e kësaj bote janë sikur rasti i vizitorit në shtëpinë e atij që e ka zbukuruar shtëpinë e vet, e i thërret njerëzit që ta shohin. Kur hyn vizitori në shtëpi, zoti i shtëpisë i ofron një pjatë të arit e në të aroma të këndshme, që ky të nuhasë aromat e të vazhdojë tutje, që edhe të tjerët të nuhasin aromën e mirë. I zoti i shtëpisë nuk ia dhuron pjatën që ky ta marrë me vete, por ky nuk e di qëllimin e zotit të shtëpisë, prandaj mendon se ena është dhuratë për të, e në zemër ndjen dashuri për enën, duke e konsideruar tash të veten. E kur i zoti i shtëpisë ia merr enën, ky zemërohet e mërzitet. Por ai që e kupton qëllimin e zotit të shtëpisë, e përdorë enën, falënderohet dhe me gëzim e në mënyrën më të mirë ia kthen.

³³ Shënon Ibn Ebi'd- Dynja. Ahmedi, Bezzari dhe Taberani shënonjnë nga Ibn Abbasi, ku thuhet se Resulallahut i vijnë dy melekë në ëndërr, dhe njëri i tregon tjetrit ngjarjen. Zingjiri i transmetuesve është i mire.

Njëjtë, ata që kanë njohur ligjet e Allahut Teala, e dinë që kjo botë është vetëm një bujtinë e përkohshme, e *'mobiluar'* për kalimtarë, e jo për qëndrim të përhershëm; është shtëpi ku njeriu përgaditet, pikërisht siç i përdorë njeriu dhomat e zbraza e të pamobiluara në të cilat nuk mendon të qëndrojë shumë e nuk lidhet për to, që to mos ketë vuajtje e pikëllim kur i braktisë.

Ja, këta ishin shembujt e dynjasë, mangësive dhe fatkeqësive të saj. Lusim Allahun Teala të na dhurojë ndihmën e Tij.

Kapitulli i katërt

HAKIKATI I DYNJASË SIPAS NJERIUT

Dije se nuk mjafton vetëm përbuzja e dynjasë, por duhet edhe të kuptosh se çfarë është ai dynjallëk i përbuzur, prej çka duhet ikur, e prej çka jo. Prandaj është e domosdoshme të shpjegohet se çka do të thotë përbuzja e dynjasë dhe prej çka duhet ikur, sepse dynjaja është armik i hapur që shmangë nga rruga e Allahut. Dynjaja dhe ahireti janë dy gjendje të zemrës. Ajo që është pranë teje quhet dynja, e kjo nënkupton gjithçka para vdekjes. E ajo që vjen më pas quhet *ahiret* e ka të bëjë me gjithçka që vjen pas vdekjes. Krejt ajo në çka ti ke fat, hise, qëllim, aspiratë e në çka kënaqesh është gjendje para vdekjes, dhe ky është dynjallëku në të cilin ti e ke hisen tënde, me atë që krejt çka është pronë e jotja e synon dynjanë, e kjo nuk është e përbuzur por mund të ndahet në tri pjesë:

1. Dobitë që vazhdojnë edhe pas vdekjes, që të bëhen miq në ahiret, e që janë vetëm dy: dituria dhe veprimi. Me termin *dituri* po mendoj në diturinë për Allahun Teala, cilësitë e Tij, veprat e Tij, melekët e Tij, librat e Tij, pejgamberët e Tij, për udhëheqjen e Tij me Tokën dhe qiejt dhe dituria që sqaron sheriatin e Pejgamberit të Tij. Me termin *veprim* po mendoj në veprim e singertë vetëm për rizanë e Allahut Teala. Dijetari aq shumë shoqërohet me dituri sa që dituria i bëhet kënaqësia më e madhe, për të cilën do të braktisë edhe gjumin, edhe ushqimin, edhe martesën; sepse diturinë e ka më të dashur se gjithçka tjetër.

Pra dituria i është bërë kënaqësia tij në dynja. Por, kur ne kemi përmendur përbuzjen e dynjasë, kënaqësinë që merret nga dituria nuk e kemi llogaritur si kënaqësi të dynjallëkut. Ndoshta ajo është prej ahiretit. Njëjtë me robin e devotshëm të Allahut; ai i përshtatet ibadetit ashtu që aty gjen kënaqësinë, e dënimi më i rëndë për të do të ishte të privohej nga kjo.

Bile, njëri ka thënë: *“Nga vdekja frikësohem vetëm sepse ajo do të m’i ndërpresë ibadetet e natës.”*

E dikush tjetër ka thënë: *“O Allah! Më jep fuqi për namaz, ruku e sexhde, edhe në varr!”*

Pra, edhe për të këtillët ibadeti është bërë një kënaqësi e parakohshme.

Gjërave të tilla që jepen kënaqësi më herët mund t’ju jepet emri *dynjallëk*, pasi që janë një gjendje afër njeriut. Por ne nuk mendojmë që ky ibadet është prej dynjallëkut të përbuzur. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Nga dynjallëku juaj, tri gjëra i kam të këndshme: aromën, gratë, dhe nurin e syrit tim – namazin.”³⁴

Resulallahu s.a.v.s., e ka konsideruar namazin kënaqësi të dynjasë, dhe gjithçka që hyn në soditje shpirtërore është dynallëk. Edhe marrja kënaqësi nga lëvizjet në ruku dhe në sexhde është dynjallëk, prandaj Resulallahu s.a.v.s., edhe e ka konsideruar kënaqësi të kësaj bote. Por temë e librit tonë është vetëm dynjallëku i përbuzur, e namazi gjithsesi se nuk bën pjesë aty.

³⁴ Shënojnë Nesai dhe Hakimi nga Enesi, por pa fjalën *selasun* (‘tri gjëra’), ndërsa e kemi përmendur edhe në Librin për martesën.

2. Pjesa e dytë është e kundërta e të parës dhe ka të bëjë me kënaqësitë në këtë botë që nuk japin kurrfarë dobi në ahiret. Të tilla janë kënaqësitë në gjynahe, por edhe kënaqja e tepruar në atë që është e lejuar, si edhe keqpërdorimi i asaj që është e domosdoshme për një jetë normale, siç mund të jetë grumbullimi i arit dhe argjendit, kuajt e bukur, bagëtia, të korrat, robët dhe shërbëtoret, kafshët shtëpiake, pallatet dhe vilat luksoze, rrobat e shtrenjta dhe ushqimet e shumëllojshme e të shijshme. Hisja që njeriu ka në gjithë këtë bën pjesë në dynjallëk të përbuzur, nëse është përtej nevojave të tij, por nëse është brenda kufijve të nevojave të tij, atëherë kjo bëhet temë e një diskutimi të gjatë.

Me demek, tregohet se kur Omer ibn Hattab r.a., e caktoi Ebu Derdan r.a., guvernator në Humus, dhe kur dëgjoji që ky i harxhoi dy dërhëmë për të ndërtuar një tendë për hije, Omeri r.a., i shkroi:

“Nga Omer ibn Hatab, udhëheqës i besimtarëve, për Uvejmirin. Po të mendoje se si Allahu Teala i shkatërroi ndërtimet e Romakëve dhe Persianëve, në këtë do të kishe mjaft arsye dhe mësim që të mos nisësh asaj rruge. Kur të mbërrijë kjo letër, me familjen tënde kthehu në Damask.”

Ebu Derda shkoi në Damask dhe aty vdiq. Omeri e shihte një hargjim të tillë si të tepërt, e ti mendo për këtë çështje.

3. Pjesa e tretë është midis pjesës së parë dhe të dytës, e kjo është dynajallëku që i ndihmon veprimet për ahiret, siç është ushqimi i domosdoshëm, një këmishë e vjetër, dhe e gjitha që njeriut i duhet për të qenë gjallë e shëndosh, e me qëllim që të përfitojë dituri dhe të veprojë.

E gjitha kjo nuk konsiderohet dynjallëk, sikur edhe pjesa e parë. Kjo është vetëm ndihmesë e pjesës së parë dhe është një rrugë për atje. Prandaj, njeriu nuk do të llogaritet prej atyre që janë dhënë pas dynjasë për ato që i përdorë nga dynjallëku me qëllim që kjo t'i ndihmojë në përfitimin e diturisë dhe në veprim. Nëse me të domosdoshmen nuk kërkohen dituria dhe veprimi por kënaqësitë e përkohshme, atëherë ato hyjnë në pjesën e dytë dhe llogariten si dynjallëk. Me vdekjen e njeriut, mbesin vetëm tri cilësi: zemra e pastruar nga të gjitha veset, kënaqësia në dhikrullah dhe dashuria për Allahun Teala.

Pastrimi i zembrës mund të arrihet vetëm me largim nga epsheet dhe kërkesat e kësaj bote, kënaqësia në dhikrullah arrihet vetëm me dhikër të shpeshtë, ndërsa dashuria për Allahun Teala është e mundur të arrihet vetëm me njohje, e njohja arrihet me tefekkur të pandërprerë. Këto tri cilësi mund t'i sjellin njeriut shpëtim dhe lumturi pas vdekjes. Pastrimi i zembrës nga kërkesat e kësaj bote është cilësi shpëtimi, sepse ajo është mbrojtje mes robit dhe dënimit të Allahut.

Në një hadith thuhet:

"Vërtetë që veprat e njeriut do t'a mbrojnë atë; kur t'i vijë dënimi nga këmbët, do të vijë ibadeti i natës e do ta mbrojë. E kur të vijë dënimi nga duart, sadakaja e tij do t'i dalë në mbrojtje."³⁵

³⁵Shënon Taberani nga Abdurrahman ibn Semur. Në listën e transmetuesve e ka edhe Halid ibn Abdurrahman Mahzumi, të cilin Buhariu e konsideron të pabesueshëm. E shënojnë edhe Ebu Hatimi dhe Ahmedi, nga Esmā, e bija e Ebu Bekrit r.a.

Kënaqësia në dhikrullah dhe dashuria për Allahun Teala e lumturojnë njeriun dhe e sjellin deri te kënaqësia më e lartë, e që është takimi me Allahun dhe shikimi i fytyrës së Tij.

Kjo lumturi fillon menjëherë pas vdekjes dhe vazhdon pafund; e kështu varri i tij i bëhet një nga bahçet e xhenetit. E si mos t'i bëhet këtij varri bahçe xheneti, kur dashuria e tij është vetëm Një, kur me dhikrin e tij të vazhdueshëm i ka tejkaluar të gjitha pengesat që e kanë penguar të ndjejë kënaqësinë e vërtetë, dhe kështu është çliruar nga burgu dhe ka larguar gjithçka që mund të gjendet mes tij e Rabbit të tij, dhe si i tillë – i lirë e i lumtur, ka ardhur te Ai që e ka dashur.

E në anën tjetër, si të mos dënohet në vdekje i dashuruari në dynjallëk, kur dynjaja ka qenë preokupimi i tij i vetëm, ky ka marrë nga dynjaja, e ajo (dynjaja) është vendosur mes tij dhe Rabbit të tij dhe ia ka mbyllur dyert e kthimit te Ai.

Prandaj është thënë:

*Si mund të jetë gjendja e atij,
që vetëm një shpresë ka,
dhe atë e humbë.*

Vdekja nuk është mosekzistencë por është ndarje nga dashuritë e kësaj bote dhe kthim Allahut. Prandaj udhëtari i ahiretit është personi që i vazhdojnë tri cilësitë e përmendura: dhikri, mendimi (*teffekur*) dhe veprimet që e largojnë nga epsheet e dynjasë.

Këto mund të arrihen me trup të shëndoshë, e trupi i shëndoshë kërkon ushqim, rroba e strehim, që secili duhet t'i sigurojë. Nëse këto të trija (ushqimin, rrobat, strehimin) në dynjallëk njeriu i përdorë brenda kufijve të lejuar e të domosdoshëm, e me qëllim që vetes t'i sigurojë ahiretin, ai nuk është pasues i dynjallëkut; për të dynjallëku është vetëm vegël për arritjen e ahiretit. E nëse ai e përdorë dynjallëkun dhe të mirat e tij me qëllim për të bërë qejfin, atëherë ai bëhet pasues i dynjallëkut dhe njeri i dynjasë.

Dashuria ndaj dynjallëkut dhe të mirave të tij mund të bëhet sepse që dërgon njeriun në dënimin e ahiretit, dhe kjo quhet haram, e mund të jetë edhe pengesë që njeriu të arrijë grada më të larta dhe e ekspozon llogaridhënies së rëndë - kjo quhet hallall. Njeriu i kuptueshëm e di që edhe qëndrimi i gjatë në Ditën e Gjykimit për të dhënë llogari, është një lloj dënimi.

Pra, kur t'i ekspozohet llogaridhënies, konsiderohet se është duke u dënuar.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Hallalli ka llogari dhe harami ka dënim.”³⁶,

e me një transmetim tjetër thuhet që edhe hallalli ka dënim.

Por dënimi për hallallin është më i butë se sa dënimi për haramin. Bile, sikur njeriu mos dënohet për hallall, atij do t'i iknin gradat e larta të xhenetit, e pendimi që do ta kaplonte për humbjen e këtyre gradave për shkak të gjërave të parëndësishme e kalimtare - gjithsesi se do të ishte dënim për të.

³⁶ Shënojnë Ibn Ebu Dun'ja dhe Bejhekiu në esh-Shu'ab si hadith *mevkuf* nga Ali ibn Ebu Talib.

Sipas kësaj mate gjendjen tënde në dynjallëk. Ti i shikon shokët e tu si ëmbëlsohen me kënaqësitë e dynjasë e zemra të vuan, ani pse ti e di se të gjitha ato janë të kalueshme e të përlyera; e si do të ishte gjendja jote po të humbasje lumturinë pambarim, e që nuk mund as të përshkruhet?!

Secili që kënaqet me të mirat e kësaj bote, qoftë edhe me dëgjimin e cicërrimës së zogjëve, vrojtimin e beharit a me një gëllënjë ujë të ftohtë, kjo shumëfish ia zvogëlon hisen në ahiret. Ky është kuptimi i fjalëve të Resulallahut s.a.v.s., drejtuar Omerit r.a.:

“Qe, edhe një gotë ujë është kënaqësi për të cilën do të pyetesh!”³⁷, duke menduar për ujin e ftohtë.

Vet fakti që njeriu do të përgjigjet në pyetje paraqet poshtërim, frikë, rrezik, vështirësi dhe pritje, e gjithë kjo zvogëlon hisen e tij në ahiret. Prandaj hazreti Omeri r.a., i shtyu me dorë ujin me mjaltë që ia ofruan kur kishte etje, duke thënë: *“Unë nuk jap llogari për to.”* Kjo botë, në sasi të vogël a të madhe, e lejuara dhe e ndaluara e saj - është e mallkuar, përpos asaj që i ndihmon njeriut në ibadet, vetëm sasia që është e domosdoshme për ibadet nuk konsiderohet dynjallëk dhe kënaqësi e dynjasë.

Secilit që i shtohet njohja, i rritet edhe kujdesi ndaj kënaqësive. Isa a.s., vendosi kokën në gur kur deshi të flejë, e më pas e largoi edhe gurin, vetëm pse i erdh shejtani e i tha: *“E dëshirove dynjallëkun.”*

³⁷Hadithin e kemi përmendur në librin *Edebi i të ushqyerit*.

Sylejmani a.s., si mbret që ishte, i ushqente njerëzit me ushqim të këndshëm e të shijshëm, e vet hante bukë elbi; në këtë mënyrë ai e testonte pushtetin e vet, sepse durimi nga ushqimi i shijshëm në rastin kur mund ta kesh e ta hash, paraqet vështirësi të madhe. Për këtë arsye, transmetohet se Allahu Teala e privoi Pejgamberin tonë s.a.v.s., nga dynjallëku dhe bukuritë e dynjasë, prandaj Resulallahu s.a.v.s, me ditë të tëra duronte uri të madhe. Resulallahu s.a.v.s., nga uria lidhte gur në bark. Allahu Teala i vendos në sprova të mëdha pejgamberët e Tij dhe robët e Tij të singertë (evliatë), sipas gradave e tyre, e krejt kjo nga mirësia dhe kujdesi i Allahut Teala ndaj tyre, që të arrijnë gradate tyre në ahiret, tamam si nëna e mëshirshme që ia ndalon fëmijës pemët ose e detyron të durojë dhimbjen e lëshimit të gjakut, e krejt kjo nga dashuria dhe kujdesi për shëndetin e tij. Prandaj, sipas kësaj shpjegimi është kuptuar se gjithçka që nuk është për rizanë e Allahut Teala konsiderohet dynjallëk, e ajo që është për rizanë e Tij, nuk është dynjallëk.

E nëse dikush pyet se cilat janë për rizanë e Allahut, do t'i përgjigjesha: dije se, ato janë tri pjesë:

a) Ajo që nuk mund as të paramendohet që është për rizanë e Allahut Teala, e kjo është ajo që e quajmë *gjynah* dhe *ndalesë* si edhe kënaqësitë e ndryshme me sende të lejuara. Krejt kjo është dynjallëk i përbuzur, pra dynjallëk në kuptimin e plotë të fjalës;

b) Ajo që në formë është për Allahun Teala, por mund të jetë edhe për dikë tjetër; e edhe këto janë tri grupe: mendimi, dhikri dhe ruajtja nga epsheet. Nëse këto të trija behën fshehtas dhe vetëm për rizanë e Allahut Teala dhe për ahiret, atëherë kjo është për Allahun, dhe nuk konsiderohet dynjallëk. Por, nëse qëllim i të menduarit, mësimit dhe edukimit është për reputacioni dhe nderi mes njerëzve; ose nëse qëllim të përmbajtjes nga dynjaja e ka kursimin, ose ka frikë për shëndetin fizik, ose me qëllim që para njerëzve të paraqitet modest e i devotshëm – atëherë kjo, në esencë, është për dynjallëk, ani pse duket sikur është për Allahun; dhe

c) Ajo që në dukje është për dynjallëk, por që në realitet mund të jetë për Allahun, siç është të ushqyerit, martesat dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me mbijetesën e njeriut dhe lozës së tij.

Nëse qëllim i kësaj është kënaqësia e kësaj bote, atëherë është dynjallëk, e nëse qëllim është për ta ndihmuar devotshmërinë, atëherë është për Allahun.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush fiton në mënyrë të lejuar në dynja me qëllim që të shtojë pasurinë e të mburret me të, do të vijë në Ditën e Gjykimit para Allahut Teala, e Ai do të jetë i zemëruar në të. E kush fiton aq sa të mos bëhet lypsar dhe që të ruajë ndershmërinë e vet, do të vijë në Ditën e Gjykimit, e fytyra e tij do të shndërrisë, ashtu siç shndërritë Hëna e plotë.”³⁸

Shih se si ndryshon gjendja sipas nijetit!

³⁸ Ebu Nuajm dhe Bejhëkiu nga Ebu Hurejre.

Po kuptohet se dynjaja përbëhet nga kërkesat për kënaqësi të përkohshme që nuk kanë lidhje me ahiretin; e kësaj i thuhet *heva*³⁹ dhe kjo është ajo për të cilën flet Allahu Teala:

“E kush iu frikësua paraqitjes para Rabbit të vet dhe ndaloi veten prej epsheve, xhenneti është vendi i tij.” 79-Naziat: 40, 41

Janë pesë sende që joshin heva-në, siç tregojnë fjalët e Allahut Teala:

“Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse *lojë, dëfrim e zbukurim*, si dhe *mburrje* ndërmjet jush e *rivalitet* për më shumë pasuri dhe fëmijë!”

57-Hadid: 20

Nga këto pesë dalin shtatë tjera, e për to gjithashtu Allahu Teala thotë:

“Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote.”

3-Ali Imran: 14

Pra, e kuptove që gjithçka që është për Allahun nuk është dynjallëk; sasitë e domosdoshme të ushqimit, strehimi dhe rrobat, gjithë kjo nuk konsiderohet dynjallëk nëse nijeti është për rizanë e Allahut; gjithçka përtej kësaj

³⁹**Heva:** dëshirë; kërkesë; dëshira e vet (nepsit); dëshirë/kërkesë e përkohshme; dëshirat (e nepsit) që janë gjynah dhe të dëmshme; kënaqësitë dhe epshet.

konsiderohet kënaqësi dhe ajo nuk është për rizanë e Allahut. Në mes të teprimit dhe të domosdoshmes ekziston një shkallë. Kësaj i thuhet *nevojë*.

Edhe nevoja ka dy anët dhe mesin. Njëra anë është afër të domosdoshmes dhe këtu nuk ka dëm meqenëse nuk është e mundur të përcaktohet plotësisht masa e të domosdoshmes.

Ndërsa ana tjetër i afrohet kënaqësisë dhe qejfit, e nga kjo duhet ruajtur.

E në mes të këtyre dy anëve është mesi, ku ka edhe gjëra të dyshimta, e kush rri afër gjërave të dyshimta, lehtë mund të bie në to.

Prandaj nevojitet vendosmëri në kujdes dhe takvallëk, dhe qëndrim në shkallën më të ulët të të domosdoshmes, duke marrë shembull pejgamberët a.s., dhe robët e singertë të Allahut. Ata gjithmonë kanë tentuar të qëndrojnë në kufi të domosdoshmes.

Uvejs Karanin familja e konsideronte të çmendur për shkak që jetonte jetë shumë të varfër. Prandaj ia ndërtuan një kolibe para shtëpisë së tyre, dhe kalonte një vit, dy e tre, e nuk ia shihnin fytyrën. Në mëngjes dilte me ezan të sabahit, e kthehej në mbrëmje, vonë pas jacisë. Ushqehej me farat që i mblidhte, e kur gjente ndonjë hurmë, ma të kegen – e linte për iftar. Po të mos gjente hurmë, shiste farat që i kishte mbledhur, e me atë vlerë do të blente diçka për të ngrënë. Vishte rrobat që i gjente të hedhura; i lante në lum e arnonte, e më pas i veshte. Ato i kishte rroba.

Nganjëherë, kur kalonte pranë fëmijëve, të cilët e merrnin për të çmendur, e godisnin me gurë, ndërsa ai thoshte:

“O vëllezërit e mi! Kur veq hedhni gurë në mua, hedhni të vegjël, kam frikë se po më del gjak në shpinë, e vjen koha e namazit, e nuk gjej ujë të pastrohem e të marr abdes.”

I tillë ishte ahlaku i Uvejsit.

Për të fliste edhe Resulallahu s.a.v.s., kur thoshte:

“E ndjej aromën e Rahmanit nga drejtimi i Jemenit.”⁴⁰, duke menduar në Uvejsin, Allahu e mëshiroftë.

Kur hazreti Omeri r.a., u caktua halife, me një maxhllis tha:

- *O njerëz! Ata që janë nga Iraku, le të ngriten në këmbë!*

Kur u ngritën, tha:

- *Le të ulen të gjithë, përpos atyre që janë nga Kufa.*

Kur u ulën, tha:

- *Le të ulen të gjithë, përpos atyre që janë nga fisi Murad.* Kur u ulën, tha:

- *Le të ulen të gjithë, përpos atyre që janë nga fisi Karan.* Të gjithë u ulën, pos njërit. Omeri e pyeti:

- *A e njeh Uvejs ibn Amir Karanin?*, duke e përshkruar.

Ky u përgjegj:

- *E njoh! Pse pyet për të, o udhëheqës i besimtarëve?! Pasha Allahun, nuk ka në mesin tonë më ahmak se ai, as më të çmendur, as më të përbuzur!* Omeri filloi të qajë, e tha:

⁴⁰Ahmedi, nga Ebu Hurejre.

- Çfarë thua?! Çfarë thua?! Vërtetë e kam dëgjuar
Resulallahun s.a.v.s., të thotë:

**“Me shëfatin (ndërmjetësimin) e tij në xhenet do të
hynë aq njerëz sa kanë fiset Rebia e Mudar.”**

Herim ibn Hajjan tregon:

“Kur dëgjova këto fjalë nga Omeri r.a., shkova në Kufa
me të vetmin qëllim - të gjej Uvejs Karanin.

Rastësisht e takova në pikë të ditës në brigjet e lumit
Tigris, ku po merrte abdes dhe i lante rrobat. E njoha sipas
përshkrimit: lëkurë të vrazhdë, kokë të rruar, mjekër të
sheshtë, shumë i dobët, fytyrë të shëmbtuar, por me
pamje të tillë që ngjallte frikërespekt. I dhash selam, e ma
ktheu selamin duke më shikuar. E zgjata dorën të
përhëndetem me të, por ai refuzoi. I thashë:

- *O Uvejs, Rahmeti i Allahut qoftë mbi ty. Si je?*

Më pas u zhyta në vaj nga dashuria dhe dhembshuria
ndaj tij, duke e parë se në çfarë gjendje ishte. Unë qaja, e
edhe ai u emocionua dhe filloi të qajë, e tha:

- *Rahmeti i Allahut qoftë edhe mbi ty, o Herim, biri i
Hajjanit! Qysh je ti, vëlla? Kush të dërgoi te unë?*

- *Më dërgoi Allahu Teala, i thashë, e ai ma ktheu:*

- *La ilahe illallah! Subhanallah! Vërtetë premtimi i
Rabbit timu përmbush!*

U habita që më njohi, e pasha Allahun as nuk më ka
parë ai mua më përpara, as unë atë. Dhe e pyeta:

- *Prej nga e di emrin tim dhe të babasë tim, e më parë
nuk jemi takuar?*

M’u përgjigj:

- *Më lajmëroi i Gjithëdituri (Alim). Kur bisedova me ty
shpirti im e njohu shpirtin tënd, sepse edhe shpirti ka*

strukturë, si materia. Disa nga besimtarët njihen mes vete dhe duhen për rizanë e Allahut, edhe nëse nuk takohen, mes vete njihen dhe flasin, qofshin në një vend apo në vende të ndryshme.

I thashë:

- Më fol për Resulallahun s.a.v.s.. Do të doja të dëgjoj një hadith prej teje; ai më tha:

- Nënë e baba i qofshin kurban atij. Unë nuk kam jetuar në kohën e Resulallahut s.a.v.s., dhe nuk jam shoqëruar me të. Por, kam qenë me njerëzit që janë shoqëruar me të, e nga ta kam dëgjuar atë çka edhe ti e ke dëgjuar. E unë nuk do të doja ta hap këtë temë; nuk dua të jem as muhaddis, as myfti, as kadi. Nuk më pëlqen të merrem me njerëz.

I thashë:

- O vëlla! Do të doja që nga ti të dëgjoj ndonjë ajet të Kur'anit dhe do të doja që t'i bësh Allahut dua për mua. Më jep ndonjë këshillë që do ta mbaj mend, sepse vërtetë shumë të dua, për rizanë e Allahut.

Ai u ngrit, më mori për dore e më dërgoi në breg të lumit, duke thënë:

Euzubilahi's-semi'il-alimi-mine'sh-shejtanirraaxhim.

Filloi të qajë, dhe tha:

- E të folurit e Rabbit tim është i vërtetë; e më pas lexoi ajetin Kur'anor:

“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t'u zbavitur!

Ne i kemi krijuar ato me qëllim të plotë, por shumica e tyre nuk e dinë.

Me të vërtetë, Dita e Gjykimit, është e caktuar për të gjithë ata.

Atë Ditë, i afërmi nuk mund ta ndihmojë aspak të afërmin e as ata vetë nuk do t'i ndihmojë kush, me përjashtim të atyre që i ka mëshiruar Allahu. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe Mëshirëplotë.”

44-Duhan: 38 - 42

Pas kësaj lëshoi një ofshamë të thellë, sa mendova që e humbi vetëdijen. E atëherë tha:

- O i biri i Hajjanit! Babai yt Hajjani ka vdekur, e edhe ti shpejt do të vdesësh, e vendi ku do të shkosh është xheneti ose xhehnemi. Edhe babai yt Ademi ka vdekur, edhe nëna jote Hava ka vdekur, ka vdekur edhe Nuhi e edhe Ibrahim, mik i Allahut.

Ka vdekur edhe Muhammedi s.a.v.s., zotëria i njerëzimit, e ka vdekur edhe Ebu Bekr, halife i myslimanëve, e edhe Omer ibn Hattabi. Ah Omer! Aaah Omer!

I thashë:

- Omeri nuk ka vdekur!, e ai më tha:

- Rabbi im më lajmëroi që Omeri ka vdekur, bile jam informuar edhe për vdekjen time dhe tënden.

Më pas tha:

- Tani unë e ti llogaritemi në mesin e të vdekurve.

Më pas i dërgoi salavat Resulallahut s.a.v.s., dhe bënte dua me zë të ulët, e pastaj tha:

- Ja këshilla ime, o Herim, biri i Hajjanit: mbaju Librit të Allahut dhe ndiq rrugën e robëve të mirë të Allahut. Kujto vdekjen e mos lejo që ai mendim të të braktisë as për një moment sa je gjallë. Njëjtë tregoju popullit tënd kur të kthehesh, dhe ndaje këshillën me të gjithë ummetin. Assesi

mos u ndaj nga bashkësia, as për një pëllëmbë, sepse duke mos e ditur, largohesh nga feja e në Ditën e Gjykimit përfundon në xehnem! Bëj dua Allahut, për mua e për ty.

Pas kësaj, tha:

- O Allah! Ky person thotë që më do për rizanë Tënde, e që më ka vizituar për rizanë Tënde, prandaj ma bëj të njohur fytyrën e tij në xhenet dhe bëj që të jetë pranë meje në shtëpinë Tënde, shtëpinë e paqes!

Ruaje sa është në dynja, kudo që të jetë; ktheja atë që i ka ikur dhe bëje të kënaqur me pak në dynjallëk, lehtësoja atë që ia ke caktuar dhe bëje falënderues për të mirat që Ti ia ke dhuruar, dhe shpërbleje me dhuratën më të mirë!

E në fund, tha:

- Po të lë në dorë të Allahut, o Herim, biri i Hajjanit! Selam ty, rahmeti e bereqeti i Allahut kofshin me ty. Më nuk do të të shoh, prandaj mos më kërko. Vërtetë nuk më pëlqen fama; vetminë e dua më shumë . Jam shumë i brengosur për këta njerëz deri sa jam në jetë. Mos pyet për mua e mos më kërko! Por dije se je në mendimet e mia, edhe nëse nuk të shoh e nuk më sheh! Më kujto dhe bëj dua Allahut për mua, se edhe unë do të kujtoj ty e do t'i bëj dua Allahut për ty, Nisu, e të nisem edhe unë!

Desha të flas edhe pak me të, por refuzoi. Kur u ndamë, filloi të qajë, e më bëri edhe mua të qaj. Ia shikova shpinën deri sa më humbi nga shikimi. Më vonë pyetja për të, por askush nuk dinte gjë; Allahu e mëshiroi.”

Ja, kështu ka qenë gjendja e udhëtarëve të ahiretit të cilët ia kanë kthyer fytyrën dynjallëkut.

Shkurtimisht, nga jeta e pejgamberëve e robëve të sinqertë të Allahut e ke kuptuar që dynjaja është hije e gjelbrimit dhe gjëra që i ka kapluar pluhuri.

E kundërta e dynjallëkut është ahireti, e kjo është gjithçka prej dynjasë që merret brenda kufijve të plotësimit të nevojave, e me çka synohet kënaqësia e Allahut dhe fuqia për ibadet - e kjo nuk është dynjallëk.

Për të shpjeguar më mirë, ja një shembull:

Nëse haxhia zotohet se në rrugë për haxh do të jetë i preokupuar vetëm me ibadet e gjatë rrugës kujdeset edhe për torbën e vet, ushqimin e devesë, ujin dhe gjithçka që i është e domosdoshme për të kryer haxhin, me këtë nuk e thyen zotimin e vet sepse këto gjëra janë të nevojshme për haxh. Njëjtë, trupi është bartës i shpirtit gjatë jetës në këtë botë.

Prandaj, angazhimi me dituri dhe ibadet për sigurimine fuqisë së trupit, konsiderohet ahiret, e jo dynjallëk. Natyrisht, nëse qëllim ka kënaqësinë e kësaj bote, konsiderohet se është larguar nga rruga e ahiretit dhe ekziston frika se zemra i ngurtësohet.

Tanafisi tregon:

“Isha pa ngrënë shtatë ditë, në hyrje të Benu Shejb në Mesxhid-i Haram, e natën e tetë, derisa isha në gjendje as fjetur as zgjuar, dëgjova një zë:

- Atij që merr më shumë se që i duhet nga dynjallëku, Allahu Teala ia verbon shikimin e zemrës.”

Pra, ky ishte shpjegimi i hakikatit të dynjallëkut për ty, këtë dije mirë. Nëse do Allahu Teala, edhe ty të udhëzon në rrugë të drejtë.

Kapitulli i pestë

PREOKUPIMI I NJERËZVE ME DYNJALLËK QËI BËRI TË HARROJNË SE NGA KANË ARDHUR DHE KU DO TË SHKOJNË

Dije se, dynjaja përbëhet nga gjërat ekzistuese, nevojat dhe kënaqësitë për njeriun, dhe angazhimin e tij, për të përmirësuar veten. Njerëzit menduan se dynjaja është vetëm njëra nga këto tri gjëra, por nuk është ashtu.

Gjërat ekzistuese që paraqesin dynjallëkun janë Toka dhe krejt çka gjendet në të. Allahu Teala thotë:

“Çdo gjë që gjendet në Tokë, Ne e kemi bërë stoli për të, për të provuar se kush prej tyre punon më mirë.”

18-Kehf: 7

Pra, Toka është një shtrojë për njerëzit, vendqëndrim dhe vendpushim i tyre, e në Tokë janë edhe veshja e tyre, ushqimi dhe pija e tyre, vendi për jeten e tyre martesore. Ne mund t'i përmbledhim gjërat në Tokë në tri grupe: minerale, bimë dhe gjallesa. Mineralet i duhen për të bërë vegla e enë - siç janë bakri e plumbi, ose për të bërë para, siç janë ari e argjendi, ose për qëllime tjera. Bima i duhet për ushqim dhe shërim. E gjallesat ndahen në njerëz dhe kafshë. Nga kafshët përdoret mishi si ushqim, e përdoren edhe për transport dhe zbukurim. Edhe njerëzit mund të përdoren për punë - siç janë shërbëtorët, ose edhe për kënaqësi - siç është kënaqja me trupin e femrës.

Gjithashtu, njeriu mund të kërkojë të përfitojë edhe zemrat e njerëzve, duke mbjellur në to madhërim dhe nderim, e kjo quhet reputacion, sepse *reputacion* do të thotë posedim i zemrave të njerëzve.

Të gjitha këto e përbëjnë dynjallëkun, e për të, në ajetin 14 të sures *Ali Imran*, Allahu Teala thotë:

- **Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët,**

kjo ka të bëjë me njerëzit;

...arin dhe argjendin e grumbulluar,

kjo ka të bëjë me minerale;

...kuajt e bukur, bagëtitë,

kjo me kafshët;

...dhe arat e lëvruara,

e kjo ka të bëjë me bimët dhe produktet e bujqësisë.

Pra, të gjithë këto janë gjëra që eksitojnë në dynja. Por, ka dy lloje të lidhjes së njeriut me to:

a) Lidhja me zemër, e që është dashuria dhe dhënia pas tyre e njeriut dhe angazhimi i tij me to, ashtu që zemra bëhet rob i tyre dhe e varur plotësisht nga to. Në këtë lidhje bëjnë pjesë të gjitha cilësitë e zemrës që kanë të bëjnë me dynjallëk, siç janë mendjemadhësia, urrejtja, lakmia, dyfytërsia, reputacioni, mendimi i keq, mashtrimi, dëshira për lavdërim, dëshira për shtim të pasurisë dhe mburrja. Këto janë dynjallëk i padukshëm (batin), ndërsa dynjallëk i dukshëm (zahir) janë gjërat që i përmendëm më lartë; dhe

b) Lidhja e dytë është me trup, e kjo është angazhimi i njeriut me gjëra të lartëpërmendura, me qëllim që t'i bëjë ato të dobishme, për vete dhe për të tjerët. Këto janë profesione dhe zanate të ndryshme me të cilat njerëzit merren.

Për shkak të këtyre dy lidhjeve njeriu e harroi veten, harroi nga ka ardhur e ku do të shkojë; pra, dashuria e zemrës për dynja dhe interesimi e angazhimi për trup. Po të dinte njeriu për vete e për Krijuesin e vet, po ta dinte hikmetin dhe fshehtësinë e dynjasë, do ta dinte se të gjitha gjërat e kësaj bote, e që ne i quajmë dynja, janë krijuar me qëllimin e vetëm që të ndihmojnë trupin i cili njeriut i shërben të arrijë Allahut Teala, sepse trupi edhe nuk mund të mbijetojë pa ushqim, pije, rroba e strehim, tamam si deveja që nuk mund të durojë e mbijetojë rrugën për haxh nëse nuk ushqetet dhe nuk kujdesemi për të.

Robi që në këtë botë harron veten dhe qëllimin e ekzistencës së vet është si haxhia që ndalet në vende të ndryshme rrugës për në haxh, që deveja të ushqehet e të pushojë, që ky ta pastrojë e rregullojë, t'i ofrojë ushqim më të mirë e ujë të freskët, e i ndodhë që karavani t'i largohet, e ai e harron edhe haxhillëkun edhe karavanin edhe mundësinë që të mbetet i vetëm në shkretëtirë, i ekspozuar rreziqeve nga bishat e egra, si ai e si deveja e vet. Haxhia i vërtetë e i vendosur nuk brengoset për devenë, përpos në atë masë që i është e domosdoshme që deveja t'a dërgojë deri te caku i tij, ndërsa zemra e tij edhe më tutje është e kthyer kah Qabeja dhe kah obligimi për të kryer haxhillëkun.

Njëjtë edhe ai që është i vetëdijshëm për rrugëtimin e vet drejt ahiretit; kujdeset për trupin vetëm aq sa i është e domosdoshme, bash sikur që përdorë nevojtoresh vetëm atëherë kur i duhet. Nuk ka asnjë dallim mes futjes së ushqimit në stomak dhe nxjerrjes së tij prej aty, sepse që të

dyja janë nevoja të trupit; brenga e vetme është që sasia e konsumuar edhe të largohet, ndërsa pikërisht stomaku është arsyeja më e shpeshtë që njeriu të harrojë Allahun Teala.

Ushqimi është i domosdoshëm, e posedimi i strehimit dhe rrobave është më pak i rëndësishëm. Sikur njerëzit të dinin arsyen e nevojës për këto gjëra e të kufizoheshin me aq, atëherë nuk do të ishin aq të dhënë pas dynjasë, sepse njerëzit jepen pas dynjasë për shkak të mosnjohjes së saj e të fshehtësive të saj, si edhe të hises së tyre në dynja. Por, njerëzit nuk dinë dhe harrojnë prandaj preokupimet e kësaj bote ngadalë i kaplojnë e i ngulfasin deri sa të humbasin në to e të harrojnë qëllimin e ekzistencës së vet në këtë botë.

Tani do të shpjegojmë cilat janë ato preokupime, si vjen deri te nevoja për to, si gabojnë njerëzit në përcaktimin e qëllimeve të tyre, si largohen nga sheriati dhe si e harrojnë përfundimin e tyre, e me qëllim që t'i kuptosh.

Angazhimet e kësaj bote janë tregtia, zanatet dhe punët tjera të njerëzve, e arsyeja e angazhimit me këto punë qëndron në faktin se njeriut i nevojiten tri gjëra: ushqimi, strehimi dhe rrobat.

Me ushqim mirëmbahet trupi, e me rroba trupi mbrohet nga të ftohtit e nxehtësia, e njëjtë edhe me strehim - mbrohet nga të ftohtit e nxehtësia, por edhe nga gjithçka që rrezikon familjen e pronën. Allahu Teala nuk i dhuroi ushqimin, rrobat e strehimin që njeriu të mos

punojë. Kjo u është dhënë kafshëve. Ato ushqehen me bimë që nuk gatohen, ndërsa të ftohtit e të nxehtit nuk ndikojnë shumë në trupin e tyre, prandaj kafshëve nuk u duhet të ndërtojnë strehimin – u mjafton shkretëtira. Ato, rroba i kanë gëzofin e lëkurën, prandaj nuk u duhen rroba tjera. Megjithatë, ky nuk është rasti me njeriun.

E nevojat e njeriut përmbliidhen në pesë profesione burimore, që paraqesin profesionet e para në këtë botë, e që janë: bujqësia, blegtoria, gjahu, endja dhe ndërtimi.

Ndërtimi siguron strehimin, endja, thurja, prerja e qepja sigurojnë rrobat, bujqësia e blegtoria ushqimin, deri sa kuajt përdoren edhe për transport. Gjahu është profesion që siguron atë që Allahu Teala e ka krijuar, qofshin këto kafshë, minarale, bimë apo drunjë, e që njeriu nuk i kultivon. Bujku kultivon bimë, çobani kujdeset për bagëtinë dhe shumimin e tyre, e gjahtari siguron atë që rritet e zhvillohet pa përzierjen e njeriut. Njeriu i mbledhë edhe mineralet nga Toka, por nuk vendos për vendndodhjen e tyre. Ky pra është profesioni i gjahtarit, e në këtë kategori hyjnë edhe plot profesione tjera.

Të gjitha këto profesione kërkojnë mjete e vegla që prodhohen nga bimët e drunjtë, ose nga mineralet, siç është hekuri, plumbi e të tjera, ose nga lëkura e kafshëve, e me çka lind nevoja edhe për tri profesione shtesë: zdrukhtari, farkëtari dhe saraqçi – e këto janë zanate.

Zdrukthtar është ai që përpunon drurin, farkëtar është ai që përpunon hekurin, por edhe bakrin, mineralet nëntokësore e të ngjashme. Qëllimi ynë është që të përmendim vetëm kategorinë e zanatit, e përndryshe ekzistojnë shumë profesione përbrenda secilës kategori. Saraq është ai që përpunon lëkurën e kafshëve. Të gjitha këto janë pra profesione burimore.

Përpos kësaj, njeriu nuk është i krijuar që të jetojë vet, por i nevojiten edhe njerëz tjerë me të cilët do të ndërlihdet. Për këtë ka dy arsye:

a) Nevoja e njeriut për shumim dhe vazhdim të llojit, e kjo është e mundur vetëm me bashkimin e mashkullit dhe femrës dhe me jetesën e tyre të përbashkët (martesa); dhe

b) Bashkëpunimi i ndërsjellë për sigurimin e kushteve për ushqim, rroba dhe edukimin e fëmijëve.

Martesa gjithsesi nënkupton shumim, ndërsa një individ nuk është në gjendje edhe të kujdeset për fëmijët edhe të sigurojë ushqimin. Përpos kësaj, njeriut nuk i mjafton të mbetet vetëm në rrethin e familjes së vet dhe vetëm brenda shtëpisë së vet. Ai nuk mund të jetojë ashtu.

Është e domosdoshme të bashkohet një grup i njerëzve dhe që secili të merret me ndonjë veprimtari prodhuese, sepse njeriu nuk është në gjendje që i vetëm të merret me bujqësi, por i nevojiten edhe veglat për këtë, e kjo nënkupton që duhet të ketë edhe zdrukthtar edhe farkëtar që do t'i prodhojnë ato vegla, por duhet të ketë edhe gjellëtar e furrëtar që do të prodhojnë bukë e ushqim.

Duhet që të kultivohet e ruhet edhe pambuku, e i duhen veglat për endje e qepje si edhe shumë vegla e mjete tjera. Prandaj njeriu nuk është në gjendje të jetojë vet, dhe nga kjo lind nevoja për bashkësinë dhe jetën në bashkësi. E edhe po të mblidheshin njerëzit në shkretëtirë të hapur, do të kishin problem me nxehtësinë, të ftohtit, shiun e hajnat, dhe prandaj u nevojitet një shtëpi e mbrojtur, ku do të tërhiqen me familjet e tyre e ku do t'i ruajnë mjetet dhe veglat. Shtëpia e mbronë njeriun nga nxehtësia, nga të ftohtit, nga shiu dhe nga shqetësimet e fqinjëve, si edhe largojnë hajnat.

Megjithatë, shtëpitë mund të sulmohen nga hajnat, kur banorët janë jashtë tyre. Prandaj u nevojitet bashkim, bashkëpunim i ndërsjellë dhe ndihmesë me qëllim të mbrojtjes, ashtu që do të ndërtojnë një mur mbrojtës, që do të rrethojë të gjitha shtëpitë e tyre, së bashku. Nga kjo kanë lindur bashkësitë e organizuara (urbane) dhe janë krijuar fshatra dhe qytete.

Pa marrë parasysh se në çfarë numri dhe në çfarë mënyre janë mbledhur njerëzit në një shtëpi, fshat ose qytet, mes tyre lajmërohen zënka; lajmërohet dëshira për udhëheqësi dhe drejtim të burrit mbi gruan, drejtim të prindit mbi fëmijët, sepse fëmija është i dobët dhe i nevojitet mbrojtje e kujdes, e secili drejtim i njeriut mbi njeriun shkakton ngatërresa, që nuk është rasti me drejtimin e bagëtisë, sepse bagëtitë nuk e kanë mundësinë e kundërshtimit, edhe kur keqpërdoren.

Megjithatë, gruaja do t'i kundërvihet burrit, e fëmija prindërve. Kjo është brenda familjes, e njëjtë është brenda qytetit ose shtetit në mes të banorëve të tij; ata bashkëpunojnë kur janë në pyetje nevojat e tyre, por edhe kacafyten rreth tyre, e po të liheshin në atë gjendje, do të vriteshin mes vete e do të shkatërroheshin.

E njëjta vlen edhe për çobanët e bujqit, që përdorin kullosën e njëjtë, tokën e ujin e njëjtë, me të cilat nuk mund të arrijnë qëllimet e veta, që gjithsesi shkakton ngatërresa mes tyre.

Përpos kësaj, disa mund të humbasin mundësinë për prodhimtari e bujqësi ashtu që verbohen, sëmuren, plaken ose ua pamundësojnë arsye tjera. Po të liheshin vetëm në gjendje të tillë, do të shkatërroheshin, e po t'u dorëzoheshin të tjerëve, ata nuk do t'u kushtonin vëmendje.

Natyrisht, nga të gjitha këto sebepe kanë lindur edhe profesione tjera, siç është për shembull aftësia e matjes së hapësirës, e me qëllim të ndarjes së drejtë të tokës mes njerëzve. Njëjtë kanë lindur edhe shërbimi ushtarak dhe prodhimi i armëve me qëllim të mbrojtjes së shtetit dhe për të larguar plaçkitësit.

Gjithashtu, këto kanë lindur edhe shërbimin e gjyqimit, që ka për qëllim të zgjidhë zënkat, e nga kjo lind edhe nevoja për drejtësi, pra për njohjen e shariatit që duhet t'ju përcaktojë njerëzve kufijtë e t'i mbajë përbrenda rregullave, që të minimizohen zënkat. Njohja e shariatit

gjithashtu nënkupton njohjen e kufijve të caktuar nga Allahu Teala. Këto janë veprimet politike dhe administrative.

Këto duhet të ekzistojnë, në mënyrë që shoqëria të organizohet e të udhëheqet me sukses, e me këto merren njerëzit që dallohen me dituri, mendjemprehtësi dhe udhëzim, dhe nëse i kushtohen asaj pune, nuk do të ketë kohë për tjetër profesion, ndërsa i nevojiten mjetet për jetesë. Prandaj është e domosdoshme të ndahen mjete për ta, sepse edhe qytetarët tjerë kanë nevojë për këso njerëz.

Gjithashtu, nëse banorët e një shteti hyjnë në luftë me armikun dhe të gjithë banorët do të merreshin me prodhimin e armëve, atëherë do të ndaleshin prodhimtaritë tjera, e nëse ushtarët do të merreshin me sigurimin e jetesës, atëherë nuk do të ketë kush t'a mbrojtë shtetin. Prandaj është e domosdoshme të ndahen mjete për ta, dhe kjo nga prona e braktisur që nuk ka pronarë, ose t'u ndahen mjete nga plaçka e luftës. E nëse u duhet më shumë, atëherë banorët duhet t'ju ndihmojnë prej pronës së tyre. Prej këtui lind nevoja për tatim, e kjo lind nevojën edhe për shërbime tjera: duhet të angazhohet dikush që bujqve e pronarëve t'u caktojë tatimin drejtë - e këta janë nëpunësit shtetëror, dikush që në mënyrën më të mirë do të mbledhë tatimin, e këta janë tatim-mbledhësit, dikush që do ta ruajë atë tatim deri sa të vijë koha për t'u shpenzuar, e që janë administruesit, si edhe dikush që gjithë këtë do ta ndajë me drejtësi.

Pra, nëse të gjitha këto profesione nuk janë të lidhura mes vete, rendi do të prishej.

Nga kjo lind nevoja për sundimtarin, i cili do të udhëheqë këto punë. Ai sundimtar do të caktojë për secilin shërbim personin konkret, që më së miri i përshtatet asaj pune.

Sundimtari ose udhëheqësi duhet të jetë i drejtë kur të caktojë tatimin dhe ndarjen e tij; ai është personi që përdorë ushtrinë në kushte të luftës, i ndanë armët, përcakton drejtimet e veprimet, emërton komandantin dhe udhëheqësit tjerë ushtarakë, si edhe në obligimet tjera të udhëheqësisë. Pas ushtrisë dhe sundimtarit që kontrollon dhe udhëheqë ushtrinë, imponohet nevoja për shkruar, kontabilist, tatimbledhës e nëpunës. Të gjithë këta, gjithashtu kanë nevojë për mjete për jetesë, e për shkak të këtyre punëve nuk mund të merren me punë tjera. Nga kjo lind nevoja për tatim shtesë, pra tatim së bashku me pronën burimore. Edhe nga kjo pikëpamje, në profesion njerëzit ndahen në tri grupe:

1) fermerët, blegtorët dhe zanatlinjtë;

2) ushtria; dhe

3) ata në mes të këtyre dy grupeve: nëpunësit, taksambledhësit, e të tjerë.

Shih si filloi nga nevoja për ushqim, rroba e strehim, e ku përfundoi. Kështu është edhe me dynjanë; sa herë i çelet një derë, ajo derë bëhet sepër dhe çelë edhe plot tjera, deri në pafundësi, thuaj se është xhehenemi i dynjasë e që thellësia e saj nuk përfundon, e kush bie në një gropë të saj, bie edhe në gropën tjetër, e kështu me radhë.

Pra, këto janë profesionet. Por këto profesione plotësohen me pronë dhe vegla.

E me *pronë* nënkuptohen gjërat që gjinden në sipërfaqen e tokës të cilat njerëzit i përdorin. Në vendin e parë është ushqimi, shtëpia, pastaj vendet ku njerëzit fitojnë, siç janë dyqanet, pazaret dhe arat, pastaj rrobat, pastaj mobiljet, shtrojat në shtëpi, dhe në fund, mjetet për zanate të caktuara.

Vegla mund të jenë edhe kafshët, siç është zagari mjet për gjah, kau është mjet për lëvrimin e tokës, e kali mjet për luftë.

Më pas, prej këtyre lind nevoja për shit-blerje, sepse bujku jeton në fshat ku nuk ka mjete për bujqësi, ndërsa farkëtari e zdrukhtari jetojnë në qytete jo të përshtatshme për bujqësi; kështu bujku nuk mundet pa farkëtarin e zdrukhtarin, e as këta dy nuk munden pa bujkun. Ata kanë nevojë të ndihmojnë njëri-tjetrin që të arrijnë qëllimet e veta, dhe ato i arrijnë përmes shkëmbimit.

Megjithatë, nëse për shembull zdrukhtari kërkon ushqim nga bujku, e për shkëmbim ofron produktin e vet, mund të ndodh që bujku për momentin të mos ketë nevojë për produktin e zdrukhtarit, ose e kundërta – mund të ndodh që zdrukhtarit për momentin nuk i nevojitet ushqim.

Kështu nevojat dhe qëllimet ndërthuren. Nga këtu ka lindur nevoja për dyqane, ku do të mblidheshin prodhimet e të gjithë zanatlinjëve e të gjenden për ata që u nevojiten, si edhe vende të posaçme ku bujqit të ekspozojnë produktet e tyre. Pronarët e dyqaneve i blejnë produktet e tyre dhe kërkojnë myshteri.

Kështu janë lajmëruar pazaret dhe magazinat ku bujku deponon drithin, e nëse nuk gjen myshteri, ai i shet me çmim më të ulët se që i shet tregtari, e më pas tregtari i deponon duke pritur myshterinë, me qëllim që të fitojë. Kështu është me të gjitha mallërat, e kjo gjendje përhapet në tërë vendin.

Më pas, domosdo vendoset komunikim mes qytetit e fshatit, njerëzit lëvizin - ushqimin e blejnë në fshatra, e mjetet për punë në qytet, dhe nga kjo jetojnë, e gjendja në bashkësi rregullohet, sepse në një qytet mund të mos gjenden të gjitha veglat për prodhimtari, e as në një fshat i gjithë ushqimi, prandaj i duhen njëri-tjetrit. Atëherë lajmërohet nevoja për transport, e disa tregtarë i kushtohen kësaj pune, e motiv kryesor e kanë fitimin – ditë e natë udhëtojnë e punojnë, që të plotësojnë nevojat e të tjerëve, ndërsa hise e tyre në gjithë këtë është fitimi, e në fund pasurinë i'a marrin hajnat ose sundimtari i padrejtë.

Megjithatë, në atë angazhimin e tyre me punë, në injorancën e tyre, në pavëmendshmërinë e tyre, Allahu Teala ka vendosur rend dhe ligj në bashkësinë nga e cila njerëzit kanë dobi. Tërë punët e dynjasë rrjedhin në këtë mënyrë. Sikur njerëzit të kuptonin këtë, do ta kthenin fytyrën nga dynjaja, e po ta bënë këtë, jeta do të ndalej e të gjithë do të shkatërroheshin, pra edhe zahidët e të devotshmit.

Pas kësaj, duke qenë që njeriu nuk është në gjendje që të bartë në shpinë mallin e vet, lajmërohet nevoja për kafshët që do të bartin mallin, e ai që posedon mall ndoshta nuk posedon edhe kafshën, prandaj mes tij dhe pronarit të kafshëve u lajmërua nevoja për marrëveshje për qira, e edhe kjo bëhet një lloj fitimi.

Pastaj, për shkak të shitblerjes së këtyre mallërave lajmërohet nevoja për para, sepse vlera e çdo malli mund të përcaktohet me një monedhë, e përndryshe, si do ta përcaktojë vlerën e njëjtë mes ushqimit e rrobave?

Shitblerja bëhet me mallëra të ndryshme, rrobat blihen në shkëmbim për ushqim, bagëtia në shkëmbim me rroba e të ngjashme, e ato nuk janë të llojit të njëjtë.

Prandaj lajmërohet nevoja për një përcaktues të drejtë, që do të ndërmjetësojë në mes të shitësit e blerësit, e të caktojë vlerën e mallit të të dyve. Kështu do të lajmërohet nevoja për mall me jetëgjatësi më të madhe, e që njerëzit gjithmonë kanë nevojë për të, e malli më i qëndrueshëm janë metalet, prandaj për prodhimin e parave merret ari, argjendi e bakri.

Më pas, u lajmërua nevoja për punimin, gravimin dhe përcaktimin e vlerës së parasë, e kjo ka lind nevojën për punëtori ku do të kryheshin këto punë dhe *sarraf*⁴¹. Dhe kështu punët janë shumë, deri sa nuk arritëm te ajo që kemi sot.

Këto janë pra punët e njerëzve, dhe ata nga to jetojnë, e asnjëra prej tyre nuk mund të kryhet pa u mësuar e ushtruar. Ka njerëz që në fëmijëri këto i neglizhojnë e nuk merren me to, ose diçka i pengon në këtë, e nuk janë në gjendje që të sigurojnë jetesën e vet, sepse nuk kanë aftësi për asnjërën punë, e megjithatë duhet të jetojnë nga diçka. Kjo i krijon dy profesione shumë të shëmtuara e të mjera: hajninë dhe lypësinë. E përbashkët e këtyre dy '*profesioneve*' është mbijetesë në llogari të të tjerëve. Njerëzit kanë frikë nga hajnat e lypsarët dhe e mbrojnë

⁴¹*Sarraf*: personi që punon me ari, argjend dhe para; këmbyses; argjendar; bankier.

pronën e vet prej tyre, prandaj edhe mendojnë se si të mbrohen.

Në mesin e hajdutëve ka edhe të tillë që bëhen të fuqishëm e me ndikim, sepse numri i tyre rritet, e kështu lëshohen edhe në grabitje me sulm. Ata që janë më të dobët gjejnë mënyra tjera që përdorin deri sa njerëzit janë të pakujdesshëm, ose thjesht fusin duart në xhepa, ose mashtrojnë në mënyra tjera.

E kur lypësi kërkon para dhe kur t'i thuhet: *“Përvil mëngët e fito edhe ti për vete, si të tjerët! Pse lypë?”*, dhe nuk i jepet gjë, atëherë ai nisë të mendojë dredhi e thotë që është i paaftë për punë.

Nganjëherë një arsyetim i tillë është i saktë, e keni grupe njerëzish që verbojnë veten e fëmijët e tyre, në mënyrë që njerëzve t’ju dhimbsen e t’ju japin para, e disa vetëm paraqiten si të verbër, të paralizuar, të çmendur ose të sëmurë, që të arsyetohen para të tjerëve dhe të përfitojnë mëshirën dhe paratë e tyre.

Të tjerët gjejnë fjalë dhe vepra me të cilat njerëzit mahniten dhe i admirojnë, e zemrat u zbuten duke i shikuar, prandaj u japin pak para, por pendohen sapo t’ju kalojë mahnitja që kishin, por atëherë pendimi nuk sjell dobi. Ata nganjëherë tallen, nganjëherë imitojnë të tjerët, nganjëherë bëjnë lëvizje qesharake, e nganjëherë me zë të bukur recitojnë poezi të pazakonta ose ndonjë prozë me rima. Poezia me rima ka ndikimin më të madh te njeriu, e sidomos kur bëhet fjalë për poezi që preferon grupet fanatiket, e nganjëherë edhe për vlerat e as’habëve dhe të ehli-bejtit.

Mund të jetë edhe poezi që ndez mall e dashuri te meraklinjtë, si për shembull ajo çfarë bëjnë daulltarët në pazar, ose ajo që ofrohet si kundërvlerë për para, e që në fakt nuk është kundërvlerë, si rasti i shitjes së hajmalive ose ndonjë lloj lule për të cilat shitësi pohon se janë ilaç, duke i mashtruar kështu të padijshmit. Të ngjashme janë edhe mashtrimi me fall dhe astrologji. Në këtë grup futen edhe vaizët e vetshpallur e të paedukuar, të cilët mundohen të zbusin zemrat e dëgjuesve të tyre, e që nga ta të nxjerrë ndonjë dinar. Veprime të këtilla e të ngjashme ka njëmijë e dymijë lloje, e të gjitha njerëzit i kanë shpikur që të fitojnë për jetesë.

Ka më shumë se dymijë llojetë mashtrimeve të gjitha i kanë shpikur njerëzit, që të fitojnë për jetesë. Këto janë veprat e njerëzve dhe punët në të cilat anagazhohen që të fitojnë për ushqim e rroba, por në ndërkohë e harruan veten, harruan qëllimin e ekzistimit të tyre në këtë botë dhe vendin përfundimtar të kthimit, kështu që mbeten në shkretëtirë dhe devijuan, u ndanë në grupe dhe kështu u lajmëruan drejtime e mendime të ndryshme.

Disa u zhytën në injorancë e gaflet dhe neglizhuan përfundimin e gjërave; thanë se qëllim i jetës së tyre është të jetojnë në këtë botë duke punuar e fituar, duke u ushqyer e duke e forcuar trupin për punë, dhe atë që e fitojnë e hanë, e përsëri punojnë për të ngrënë. Kjo është rruga e bujqve dhe zanatlinjve, si edhe i atyre që nuk kanë për qëllim kënaqësitë e kësaj bote, por as në fe nuk janë të edukuar. Të këtillët lodhen gjatë ditës për të ngrënë në mbrëmje dhe hanë natën për t'u lodhur gjatë ditës, e kështu në vazhdimësi, deri sa vdekja t'i ndalojë.

Disa të tjerë pohojnë që i kanë kuptuar të gjitha, dhe që njeriu nuk duhet të lodhet me punë e as të vrapojë pas të mirave të kësaj bote. Ata mendojnë se lumturia është në kënaqjen e epsheve të stomakut e të organit seksual. Ata e harruan veten e u kthyen kah gratë dhe ushqimet e shijshme; hanë siç hanë kafshët, duke menduar që me këtë po arrijnë lumturinë e kësaj bote, por kjo gjendje i largoi ata nga mendimi për Allahun dhe ahiretin.

Grupi i tretë mendon se lumturia është në pronë e pasuri. Ata kalojnë netë të tëra pa gjumë e ditë duke u lodhur, e krejt me qëllim që të pasurohen; lodhen duke udhëtuar ditë e natë, punojnë punë të rënda e fitojnë, por hanë vetëm aq sa u nevojitet, nga koprracia e nga frika se pasuria u pakësohet, e në këtë gjejnë kënaqësinë dhe për këtë punojnë deri në vdekje. Atëherë mbesin nën dhé ose me shije i hanë krimbat, kështu që atyre u mbetet lodhja dhe fatkeqësia, e krimbave lezeti. Edhe ata pas tyre e shohin gjithë këtë, por megjithatë ndjekin rrugë të njejtë, e nuk nxjerrin mësim.

Grupi i katërt mendon që lumturia është në nderim dhe lëvdata. Ata lodhen duke fituar për jetë dhe kursejnë në ushqim e pije, por harxhojnë në rroba të bukura e të stolisura, si edhe në kafshë të shtrenjta; i zbukurojnë hyrjet në shtëpitë e tyre dhe gjithçka që i ekspozohet shikimeve të njerëzve, me qëllim që njerëzit të thonë se ata janë të pasur e të fortë. Të këtillët aty e gjenë gëzimin dhe lumturinë., dhe të gjitha veprimet e tyre janë në këtë drejtim.

Grupi i pestë mendon se lumturia është në reputacion dhe pozitë të lartë mes njerëzve, në atë që të tjerët t'ju përkulen dhe t'i respektojnë. Ata veprimet e tyre i drejtojnë që t'i përfitojnë njerëzit dhe nënshtrimin e tyre, duke tentuar që të sillen si sundimtarë, që të arrijnë ndikim në një grup të njerëzve dhe duke menduar që do të jenë të lumtur nëse pushteti dhe ndikimi i tyre zgjerohet dhe nëse njerëzit u nënshtrohen.

Ata mendojnë që ky është kulmi i lumturisë dhe qëllimi i tyre kryesor. Këto janë kërkesat më të shpeshta në zemrat e të pavëmendshmit; ata vazhdojnë që për vete të fitojnë dashurinë dhe afërsinë e njerëzve, në vend të dashurisë dhe afërsisë së Allahut Teala, në vend që t'i bëjnë ibadet Allahut dhe në vend që të mendojnë për ahiret dhe për kthimin përfundimtar.

Përpos këtyre, ka edhe plot grupime, më shumë se shtatëdhjetë, që kanë devijuar e edhe të tjerët i kanë devijuar, e në atë rrugë i ka dërguar nevoja për ushqim, rroba e banim; ata e harruan qëllimin e këtyre tri nevojave dhe masën e tyre të mjaftueshme në dynja, dhe kjo i dërgoi në thellësi nga të cilat nuk mund të dalin.

Ata që e dinë qëllimin e këtyre nevojave nuk dalldisen në këto veprime; ata e njohin sa është hisja e tyre në to dhe sipas saj veprojnë. E padyshim se qëllim është shpëtimi nga shkatërrimi. Kur të këtillët të ndjekin rrugën e modestisë, atëherë i braktisin brengat dhe preokupimet dhe zemrat e tyre mbesin të zbrasta, ashtu që atë vend e zë kujtimi për ahiret, e veprimet e tyre drejtohen kah përgaditja për ahiret.

Kur njeriu e tejkalon masën përtej asaj që i duhet, atëherë brengat dhe punët e tij shtohen në pafundësi, e kur të këtillet të lëshohen në luginat e kësaj bote, Allahu Teala nuk brengoset se në cilën luginë do t'i shkatërrojë. Fatkeqësisht, pendimi i fundit nuk jep dobi. Pra kjo është gjendja e atyre që dalldisen pas kësaj bote.

Një grup njerëzish e vërejti këtë, prandaj ia kthyen fytyrën dynjasë, por shejtani ua pat zili në këtë e nuk i la rehat, prandaj edhe ata i devijoi, kështu që edhe këta u ndanë në grupe.

Një grup mendojnë se kjo botë është shtëpi e telasheve dhe sprovave, e ahireti shtëpi e lumturisë për të gjithë që arrijnë atje, edhe nëse bëjnë ibadete edhe nëse nuk bëjnë. Të këtillet i konsiderojnë të drejta veprimet e atyre që e vrasin veten që të çlirohen nga telashet e sprovat. Mendim të këtillet ka edhe një grup në Indi, të cilit e djegin veten duke menduar që në këtë mënyrë do të shpëtojnë nga sprovat e kësaj bote. Grupi i dytë menduan që vetvrasja nuk shpëton, por para kësaj duhet që në vete të mbysin cilësitë njerëzore dhe plotësisht të çlirohen nga to; të këtillet mendojnë se lumturia qëndron në shtypjen e epsheve dhe zemërimit, dhe filluan të mendojnë veten deri sa nuk u shkatërruan – disa humbën mendjen, e të tjerët u sëmurën dhe iu mbyll rruga e ibadetit. Disa nuk mundën t'i largojnë plotësisht cilësitë njerëzore, prandaj menduan se është e pamundur të plotësohen detyrimet e shariatit dhe që sheriati është i shpikur e nuk ka bazë, dhe kështu kaluan në mosbesim. Të tjerët nga ky grup menduan që gjithë ai mundim është për Allahun Teala, por se Allahut nuk i duhet

ibadeti jonë, dhe kështu përsëri iu lëshuan epsheve duke neglizhuar sheriatin dhe rregullat e tij. Bile edhe pohuan që një veprim i tillë i tyre paraqet pastërtinë e besimit të tyre, pasi që, siç thonë ata, Allahu Teala nuk ka nevojë për ibadetet tona.

E grupi i tretë besonte se qëllim i ibadetit është angazhimi në vetë-edukim, që dërgon në njohje të Allahut Teala, e kur të realizohet njohja, aty përfundon angazhimi, dhe atëherë njeriut nuk i duhet ibadeti. Kështu e braktisën ibadetin duke menduar se arritën grada të larta në njohje të Allahut Teala, sepse obligimet vlejné vetëm për njerëzit e rëndomtë. Këtë mendim e mbajnë shumë grupe e drejtime të devijuara, të cilat vështirë edhe të numërohen, por sigurisht që janë më shumë se shtatëdhjetë.

Në mesin e gjithë këtyre grupeve, një është që ka shpëtuar, e ky është grupi që ndjekë rrugën e Resullallahut s.a.v.s., dhe as'habëve të tij. Ky grup nuk braktisë plotësisht dynjallëkun por as nuk dalldisen plotësisht në epshe.

Nga dynjallëku duhet marrë aq sa është e nevojshme, ndërsa duhet shuar vetëm ato epshe që kundërshtojné sheriatin dhe mendjen; nuk duhet pasuar secilin epsh dhe nuk duhet shpërfillur secilin epsh – duhet ndjekur rruga e mesme, e kjo nënkupton që të mos braktiset gjithçka prej dynjallëkut, e as të mos merret gjithçka prej tij.

Duhet njohur dhe kuptuar qëllimin e gjithçkaje që Allahu Teala ka krijuar në dynja, dhe ajo të respektohet e të ruhet. Prandaj, nga ushqimi duhet marrë vetëm aq sa

është e domosdoshme ta bëjë trupin të aftë për ibadet, për strehim të merret ajo që mjafton për mbrojtje nga hajnat, nxehtësia e të ftohtit, e njëjtë edhe për rroba.

Sepse, kur zemra të çlirohet nga brenga për trupin, atëherë me gjithë forcën kthehet kah Allahu Teala dhe gjithë jetën ia kushton dhikrit (përkujtimit) dhe teffekurit (mendimit).

Njëjtë, një zemër e tillë vazhdimisht përcjellë, vrojton dhe kontrollon epshtet, që të mos dalë nga kufijtë e devotshmërisë frikës prej Allahut dhe respektit ndaj Tij. Kjo mund të njihet në detaje vetëm nëse ndiqet rruga e grupit të shpëtuar, e kjo është rruga e as'habëve, sepse, kur Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Vetëm një grup është i shpëtuar**, e as'habët pyetën:

- *Cili është ai grup, o Resulallah?!"*, Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

- **Janë ata që ndjekin sunnetin tim dhe i mbahen bashkësisë** (*ehlus-sunne vel-xhemma*).

Dikush pyeti:

- *Kush janë pasuesit e sunnetit dhe bashkësisë?*, e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Janë ata që ndjekin rrugën time dhe rrugën e shokëve të mi.**⁴²

⁴² Shënon Tirmidhiu nga Abdullah ibn Amr, duke vërtetuar besueshmërinë e tij. E shënojnë edhe Ebu Davudi, nga Muaviu dhe Ibn Maxhe, nga Enesi dhe Avfa ibn Malik, me zingjir të mirë të transmetuesve.

Ata kanë ndjekur rrugën e drejtë e të qartë, që e kemi shpjeguar më herët. Gjithashtu, ata nuk e braktisën dynjallëkun në tërësi dhe nuk ishin asketë.

Ata as nuk e tepronin as nuk shkonin në ekstrem, por ndiqnin rrugën e mesme, e kjo është më e dashura për Allahun Teala, për çka më herët kemi folur në disa raste, e Allahu e di më së miri.

Ky është fundi i Librit të përbuzjes së dynjasë. Në fillim e në fund hamd i takon Allahut Teala, ndërsa Resulallahut s.a.v.s., familjes e as'habëve të tij, salavat e selam.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
PËRBUZJA E DYNJASË	7
CILËSITË E DYNJASË	39
KRAHASIMET E DYNJASË	49
HAKIKATI I DYNJASË SIPAS NJERIUT	65
PREOKUPIMI I NJERËZVE ME DYNJALLËK QË I BËRI TË HARROJNË SE NGA KANË ARDHUR DHE KU DO TË SHKOJNË	83

